



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**

**PËR**

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL  
AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN BUJQËSOR DHE RURAL (AGJENCIA E PAGESAVE)**

*(Institucion i administratës shtetërore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë  
dhe Zhvillimit Rural)*

**Tiranë, Tetor 2018**

## RAPORT

### **Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), institucion i administratës shtetërore, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes të miratuar me vendimin nr. 1, datë 3.1.2018 dhe të vendimit nr. 19, datë 4.4.2018 *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR)”*, ka filluar mbikëqyrjen e përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në institucionin Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), institucion i administratës shtetërore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua sipas Programit të Mbikëqyrjes nr. 386/1 prot., datë 4.4.2018, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresat nr. 386/2, 386/3 dhe 386/4 prot., datë 4.4.2018 *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”*. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në institucion në datën 10.4.2018.

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjencia e pagesave, në kuptim të nenit 21, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, *“Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”*, është institucion i administratës shtetërore në varësi të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Organizimi dhe funksionimi i AZHBR-së, mbështetet në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”*, i ndryshuar me vendimin nr. 877, datë 14.12.2016 të Këshillit të Ministrave *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”*.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, si institucion në varësi të ministrit përgjegjës për bujqësinë, u përfshi në listën e institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil, parashikuar në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, (ndarja me numër rendor 20). Por në rastin e këtij

institucioni, përcaktimet e ligjit për nëpunësin civil u zbatuan deri në momentin e miratimit të vendimi nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, ku në pikën 9 parashikohej se “Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë” dhe më tej në pikën 15, parashikohej se “Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 3, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndarja me numër rendor 20 shfuqizohet”. Më pas, këtij akti nënligjor i janë bërë ndryshime dhe shtesa me vendimin nr. 877, datë 14.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”.

Me këto ndryshime, ndër të tjera ka ndryshuar pika 9, e VKM nr. 719, datë 31.10.2014, duke u bërë si më poshtë:

*“Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të AZHBR-së, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës”.* Më tej, është shfuqizuar pika 15, e VKM nr. 719, datë 31.10.2014, e cila parashikonte daljen e institucionit të AZHBR-së nga fusha e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të gjithë instituteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në subjektin e mbikëqyrur, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Behare Hoxha dhe Zamira Mujali, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

Me shkresën nr. 386/6 prot., datë 19.7.2018 të Komisionerit, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Subjekti i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 1072/2 prot., date 3.8.2018, “Kthim përgjigje”, ka njoftuar Komisionerin lidhur me planin e masave të marra dhe adresimin e tyre për zgjidhje në zbatim të rekomandimeve të bëra nga grupi i mbikëqyrjes, duke mos paraqitur vërejtje lidhur me gjetjet e trajtuara në pjesët respektive të projektraportit. Bashkë me mbikëqyrjen në projektraport janë trajtuar edhe disa kërkesa të paraqitura për shqyrtim pranë Komisionerit nga nëpunësit e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* si dhe verifikimi i ligjshmërisë së procedurës së kryer për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për

Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), i filluar kryesisht nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me urdhrin nr. 364 prot., datë 26.3.2018. Në përmbajtjen e materialit “*Kthim përgjigje*”, dërguar Komisionerit, institucioni i mbikëqyrur ka sqaruar se, procedurat administrative lidhur me këto raste janë në proces dhe po ndiqen në vazhdimësi, duke mos paraqitur vërejtje lidhur për sa është konstatuar në projektraport. Nga ana e Komisionerit u analizua përmbajtja e këtij materiali, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes dhe qëndrimi në lidhje me të, është materializuar në pjesët përkatëse të raportit.

Me shkresën nr. 386/7 prot., datë 19.7.2018 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR)*”, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që është ministria nga e cilat varet institucioni i mbikëqyrur.

Me shkresën nr. 386/8 prot., datë 19.7.2018 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR)*”, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje edhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur.

Njësia përgjegjëse DAP, me shkresën “*Kthim përgjigje*”, me nr. 5604/1, prot., datë 7.8.2018, bën me dije Komisionerin se pas administrimit të projektraportit të mbikëqyrjes, ka shqyrtuar praktikatat e konfirmimit për 16 nëpunës e më pas, për këta nëpunës, ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të nëpunësit në përfundim të periudhës së provës.

Në këto rrethana, duke u konsideruar e plotësuar kërkesa për zbatimin e procedurës në këtë rast, u hartua edhe raporti përfundimtar i mbikëqyrjes.

### **Qëllimi i mbikëqyrjes:**

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë së linjës dhe njësisë përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil i konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi dhe shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

### **Objekti i mbikëqyrjes:**

Mbikëqyrja është orientuar drejt verifikimit të situatës së administrimit të shërbimit civil në këtë institucion, për të arritur në konkluzion se si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me respektimin e skemës së administrimit të shërbimit civil si dhe të procedurave që ndiqen gjatë aplikimit të instituteve të ligjit.

1. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:

- Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
- Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji, nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit ose për një periudhë më pak se 1 vit.
- Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
- Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve;
- Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse (*kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.*).

2. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:

- Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
- Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.  
(*Të evidentohen rastet kur, nëpunësit përgjegjës, analisti i punës/ eprori direkt/ Sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse, nuk kanë hartuar dhe miratuar përshkrime pune për pozicionet e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.*)

3. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
4. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, nga momenti i fillimit të efekteve juridike të aktit nënligjor që e ka përfshirë institucionin në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar e në vijim.
5. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës, detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe.  
*(Të evidentohen rastet e mospërmbylljes në afat të procedurave të konfirmimit të nëpunësve civilë në periudhë prove, sipas parashikimeve të ligjit, si dhe nëpunësit përgjegjës, që ligji i ngarkon me detyra të posaçme gjatë zbatimit të këtij instituti të ligjit).*
6. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste *(ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit).*
7. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj, duke verifikuar se si janë zbatuar kërkesat ligjore për procedurat që janë zhvilluar në këto raste.
8. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm.  
*(Të evidentohen të gjitha rastet e aplikimit të këtij instituti. Nëse ka pasur të tilla, të verifikohet procedura e ndjekur. Të verifikohen rastet e ankmuara në gjykatë dhe rastet e vendimeve të formës së prerë për rikthim në pozicionin e mëparshëm të punës).*
9. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces nga momenti i fillimit të efekteve juridike të aktit nënligjor që e ka përfshirë institucionin në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar e në vijim. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit *(Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues).*  
  
*(Të evidentohen rastet e mospërmbylljes së procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë, sipas parashikimeve të ligjit, si dhe nëpunësit përgjegjës, që ligji i ngarkon me administrimin e shërbimit civil, në lidhje me institutin e vlerësimit të punës).*

10. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
11. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

### **Metodologjia e mbikëqyrjes:**

Për kryerjen e mbikëqyrjes është zgjedhur si metodë pune verifikimi i dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në Sektorin e Burimeve Njerëzore.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u ndërmorën veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht, në datën 10.4.2018, u realizua një takim njohës me burimet njerëzore të subjektit të mbikëqyrur. Në këtë takim u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion për verifikim nga grupi i mbikëqyrjes.
- Nëpunësi **\*\*\*\*\***, me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Përafrimit të Legjislacionit dhe Ndihmës së Huaj”, në Drejtorinë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, u caktua si person kontakti me grupin e punës. (Ndjekja e detyrave të Përgjegjës të Sektorit të Burimeve Njerëzore, i është caktuar si detyrë shtesë e përkohshme, me urdhrin nr. 78, dt. 3.1.2018, të titullarit të institucionit).
- U verifikuan pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas strukturës dhe organikës në fuqi në momentin e fillimit të efekteve juridike të vendimit nr. 877, datë 14.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, që e ka përfshirë institucionin në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- U verifikuan pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas strukturës dhe organikës në fuqi në momentin e mbikëqyrjes, si dhe listëprezencat e punonjësve për periudhën dhjetor 2016, janar 2017 dhe mars – prill 2018.
- Për nëpunësit e emëruar në pozicione të shërbimit civil u verifikua dokumentacioni i përfshirë në dosjet e personelit, të cilat administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore.

- U verifikuan procedurat e rekrutimit, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji, lidhur me kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë një nëpunës i pranuar në shërbimin civil.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës, të çdo nëpunësi, për të provuar përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës, si arsimi, përvoja në punë e të tjera.
- Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete (*Tabela 1 dhe 2*), të cilat i bashkëlidhen raportit si pjesë e tij.

## **Përmbajtja e Raportit:**

### **I. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë.**

#### ***I.a) Organizimi i pozicioneve të shërbimit civil në institucionin Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR).***

Nga analiza dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, u konstatua se, në datën e fillimit të efekteve juridike të vendimit nr. 877, datë 14.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, që e ka përfshirë institucionin në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, (në dt. 22.12.2016), Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, ishte e organizuar dhe funksiononte në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar me urdhrin nr. 156, datë 1.12.2015 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”. (VKM nr. 877, dt. 14.12.2016, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 247, viti 2016, datë 22 dhjetor 2016, hyrja në fuqi është përcaktuar pas botimit në Fletoren Zyrtare). Bazuar në këtë strukturë dhe organikë, në momentin e përfshirjes në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, (në dt. 22.12.2016), institucioni i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), kishte **123** pozicione pune gjithsej, ku

- **1 pozicion pune**, Drejtor i Përgjithshëm.
- **120 pozicione pune**, konsiderohen pjesë e shërbimit civil, (6 pozicione me emërtesën “drejtor drejtorie”, me kategori page III-a + 18 pozicione me emërtesën “përgjegjës sektori”, me kategori page III-a/1 + 69 pozicione me emërtesën “inspektor”, me kategori page III-b + 27 pozicione me emërtesën “specialist”, me kategori page IV-a).
- **2 pozicione pune janë punonjës administrativ**, (1 pozicion me emërtesën “punonjës pastrimi” + 1 pozicion me emërtesën “shofer”).



Kjo mënyrë organizimi ka vazhduar deri në momentin e fillimit të efekteve juridike të strukturës dhe organikës së re, të miratuar me urdhrin nr. 190, datë 6.11.2017 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave)”. Kjo strukturë është struktura në fuqi edhe në momentin e mbikëqyrjes. (Për shkak të miratimit të kësaj strukture, institucioni ka kaluar në proces ristrukturimi. Ky proces është trajtuar në mënyrë të hollësishme në vijim të këtij materiali, në pikën VI “Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste, ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin si dhe rastet e tjera të transferimit”.

Nga analiza e strukturës dhe organikës që është në fuqi në momentin e mbikëqyrjes, rezulton se, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka **133** vende pune gjithsej, të organizuara si më poshtë:

- **1** pozicion pune, Drejtor i Përgjithshëm.
- **129** pozicione pune, konsiderohen pjesë e shërbimit civil, (6 pozicione me emërtesën “drejtor drejtorie”, me kategori page III-a + 19 pozicione me emërtesën “përgjegjës sektori”, me kategori page III-a/1 + 78 pozicione me emërtesën “inspektor”, me kategori page III-b + 26 pozicione me emërtesën “specialist”, me kategori page IV-a).
- **3** pozicione pune, punonjës administrativ, (1 sekretar + 1 punonjës pastrimi + 1 shofer).

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, nisur nga emërtesa e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, ato paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese, janë **6** pozicione pune, ose rreth **4,6 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor drejtorie”, kategoria e pagës III-a.
- Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese, janë **19** pozicione pune, ose rreth **14,6 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori”, kategoria e pagës III-a /1.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **104** pozicione pune, ose **80 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil. Në këtë grupim përfshihen 78 pozicione me emërtesën “Inspektor”, kategoria e pagës III-b dhe 26 pozicione me emërtesën “Specialist”, kategoria e pagës IV-a.

Konstatohet se, njësitë organizative me emërtesën “Drejtori”, janë organizuar sipas drejtimeve kryesore funksionale, me nëndarje pozicionesh në “përgjegjës sektori”, e më pas në “inspektor” dhe “specialist”.

**Konkluzion:**

- Në përmbajtjen e strukturës organizative të institucionit të mbikëqyrur, evidentohen në mënyrë të qartë, pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, si dhe pozicionet e punës ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil.
- Numri i punonjësve për çdo njësi organizative, është brenda kufirit të miratuar me ligjin për administratën shtetërore.

***I. b) Vlerësimi i pozicionit Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si titullar i një institucioni në varësi të ministrit përgjegjës për bujqësinë, në raport me shërbimin civil.***

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), si ent publik buxhetor, me statusin e personit juridik, publik, në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e bujqësisë, është krijuar me ligjin nr. 9817, dt. 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, i cili edhe aktualisht është në fuqi pa iu bërë asnjë shtesë apo ndryshim. Në pikën 3 e 4, të nenit 21 të këtij ligji është parashikuar se:

(pika 3) “Organizimi, funksionimi, shtrirja territoriale, si dhe mënyra e rekrutimit të punonjësve të agjencisë së pagesave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

(pika 4, “Drejtori i agjencisë së pagesave emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozim të ministrit përgjegjës për çështjet e bujqësisë”.

Vendimi i mëparshëm që rregullonte organizimin e AZHBR-së, me nr. 719, datë 31.10.2014, i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, në pikën 8 parashikonte: “Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”. Me vendimin nr. 877, datë 14.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, ndër të tjera, është shfuqizuar pika 8, e VKM nr. 719, dt. 31.10.2014.

Gjithashtu me ndryshimet që i janë bërë aktit bazë me të cilin është organizuar dhe funksionon AZHBR, (ndryshimet dhe shtesat që i janë bërë VKM nr. 719, dt. 31.10.2014), është ndryshuar edhe pika 9 si më poshtë:

*“Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativ të AZHBR-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës”.*

Pra, në bazë të ligjit të posaçëm, i vetmi rregullim i parashikuar në mënyrë të specifikuar për emërimin në detyrë dhe lirim apo shkarkimin nga detyra të Titullarit apo Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së, është ai i parashikuar në pikën 4, të nenit 21 të ligjit.

Por, tashmë institucioni i AZHBR-së si institucion i administratës shtetërore në varësi të ministrit përgjegjës për bujqësinë është pjesë e shërbimit civil. Bazuar në rregullimet që parashikon pika 5, e kreut II, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, pozicionet e punës me emërtesën titullarë të institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës, janë nëpunës civilë të kategorisë *“Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues”*.

Me urdhrin nr. 108, datë 17.7.2017, të Kryeministrit, në detyrën e Titullarit të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), është emëruar \*\*\*\*\*. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet medias është njohur me pretendimin publik të një subjekti politik, për parregullsi në procedurën e ndjekur për emërimin e kryer në këtë rast e në këto rrethana, me urdhrin nr. 364 prot., datë 26.3.2018 *“Për verifikimin e rastit të publikuar nga media, në lidhje me emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR)”*, ka filluar kryesisht verifikimin e ligjshmërisë së procedurës së kryer për emërim. Lidhur me nisjen e procesit të verifikimit të këtij rasti, me shkresat nr. 364/1 prot. e nr. 364/2 prot., datë 26.3.2018 të Komisionerit *“Njoftim mbi fillimin e verifikimit”*, është njoftuar edhe Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural dhe Departamenti i Administratës Publike.

Gjatë verifikimeve të kryera pranë institucionit të AZHBR-së u konstatua se, vlerësimi i faktit nëse pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së, është ose jo pozicion i shërbimit civil i nivelit të lartë drejtues, është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ky fakt provohet me vendimin nr. Regj.Them 142231157-00563-80, datë regj. 25.1.2018 dhe nr. vendimi 1385(80-2018-1416, datë 16.4.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditës Suela Popa, ish Drejtor i Përgjithshëm i AZHBR-së, i paditur Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural dhe Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, me objekt: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin nr. 98, datë 1.6.2017 *“Për lirim nga detyra”*, të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. (Ankim nr. 1482/1 prot., datë 2.5.2018 i AZHBR-së, drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë).

Në këto kushte, referuar parimit të sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, dt. 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar, sipas të cilit, institucionet e tjera shtetërore nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se kjo çështje do të marrë zgjidhje përfundimtare pas përfundimit të procesit gjyqësor, ku do të vlerësohet situata. Në këtë kuadër, ndër të tjera, gjykata do të shprehet edhe për rregullat që duhet të zbatohen lidhur me emërimin, lirimimin dhe shkarkimin e Titullarit të AZHBR-së, duke i dhënë zgjidhje përfundimtare.

***I.c) Punonjës të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil, në momentin e përfshirjes së institucionit në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, (në dt. 22.12.2016).***

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural u përfshi në listën e institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil, (VKM nr. 142, dt. 12.3.2014, lidhja nr. 1, “Lista e institucioneve të administratës shtetërore”, ndarja me numër rendor 20), duke qëndruar në këtë listë deri në momentin e miratimit të vendimit nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, i cili në pikën 9 të tij përcaktonte se “Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë”.

Më pas, me ndryshimet që iu bënë këtij akti nënligjor, me vendimin nr. 877, datë 14.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, ky institucion u përfshi përsëri në listën e institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil. Akti nënligjor i ndryshuar, ndër të tjera ka ndryshuar pikën 9, si më poshtë:

*“Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativ të AZHBR-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës”.*

Më tej është shtuar pika 17, me përmbajtjen si më poshtë:

*“Për nëpunësit aktualë të AZHBHR-së zbatohen dispozitat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar”.*

Neni 67 i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, rregullon regjimin juridik të marrëdhënies së punës, për të gjithë ata nëpunës apo punonjës që në momentin e fillimit të efekteve juridike të këtij ligji, ishin të punësuar në pozicione të konsideruara pjesë e shërbimit civil. Në mënyrë të shprehur, në pikat 3, 4 dhe 6, të këtij neni përcaktohet se:

(pika 3) “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”.

(pika 4) “Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”.

(pika 6) “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.

Më tej, vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar në pikën 1, të kreut III “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunitat”, përcakton se:

“Punonjës ekzistues”, sipas pikës 3, të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, që kryejnë funksione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore e komuna, dhe a) janë rekrutuar sipas procedurave të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, por që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil; apo b) janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë nëpunës civilë për shkak të ligjit”.

Dispozitat e sipërpërmendura, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarin e statusit të punësimit, për të gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të vendimit nr. 877, datë 14.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, (në dt. 22.12.2016).

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga strukturat përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, (njësia e burimeve njerëzore e institucionit, Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse), nëse procedurat e realizuara për deklarin e statusit të punësimit janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, gjatë procesit të mbikëqyrjes u verifikuan dhe analizuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet e shërbimit civil, si struktura dhe organika e institucionit që ishte në fuqi në dt. 22.12.2016; listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve për muajin dhjetor 2016 dhe janar 2017; dosjet individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (aktet e emërimit si dhe të dhënat lidhur me nivelin e diplomës dhe profilin e arsimit të lartë), si dhe plotësimi i

kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Nga përpunimi dhe analiza e këtij dokumentacioni konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve të vendimin nr. 877, datë 14.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, (në dt. 22.12.2016), ashtu si e kemi përmendur edhe me sipër në këtë material, **AZHBR kishte 120 pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, ku 119 prej tyre ishin të zëna dhe 1 pozicion ishte vend i lirë, (ishte vend i lirë 1 pozicion për “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit, në Drejtorinë e Kontrollit).**

Vendimi nr. 719, datë 31.10.2014 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, i pa ndryshuar, në pikën 9 të tij përcaktonte se “Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë”. Në këto kushte, deri në momentin e fillimit të efekteve juridike të vendimin nr. 877, datë 14.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, (në dt. 22.12.2016), mënyra e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënies së punës, zhvillimi i karrierës, garantimi i të drejtave dhe përcaktimi i detyrimeve për punonjësit e AZHBR-së, është rregulluar me ligjin nr. 7661, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

***I.d) Procedura e deklaramit të statusit të punësimit, për punonjësit, që kryenin funksione në shërbimin civil, në momentin e përfshirjes së institucionit në fushën e veprimt të ligjit për nëpunësin civil, (në dt. 22.12.2016).***

Bazuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, neni 4, shkronja “f”, Departamenti i Administratës Publike, paraqitet si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur. Ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, e ngarkojnë njësinë përgjegjëse me disa detyra dhe përgjegjësi specifike, të cilat rrjedhin prej tyre, ndër të cilat edhe deklaramin e statusit të punësimit, sipas parashikimeve të nenit 67 të ligjit.

Më konkretisht, pika 6, e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, përcakton se, “*Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit*”.

Më tej, në mbështetje të pikës 8, të nenit 67, të ligjit është miratuar vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në përmbajtjen e të cilit janë përcaktuar procedurat e hollësishme, që duhet të kryejë njësia

përgjegjëse, për të realizuar deklarin e statusit të punësimit për punonjësit dhe nëpunësit aktualë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se:

Njësia e burimeve njerëzore pranë institucionit të mbikëqyrur, pasi ka evidentuar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, si dhe punonjësit e punësuar në këto pozicione, me shkresat nr. 496 prot., dt. 21.2.2017; nr. 538 prot., dt. 28.2.2017 dhe nr. 605, dt. 7.3.2017 “*Dosjet e personelit të nëpunësve të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor Rural*”, i ka dërguar njësisë përgjegjëse DAP, listën e plotë të punonjësve të AZHBR-së; materialet që përmbanin të dhëna lidhur me mënyrën dhe kohëzgjatjen e punësimit; aktet individuale të emërimit, si dhe materialet shkresore me të dhënat individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil. (*Shkresat nr. 496 prot., dt. 21.2.2017; nr. 538 prot., dt. 28.2.2017 dhe nr. 605 prot., dt. 7.3.2017 “Dosjet e personelit të nëpunësve të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor Rural”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike dhe për dijeni Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*).

Pas kësaj, Departamenti i Administratës Publike, për çdo të punësuar në pozicione të shërbimit civil, ka verifikuar periudhën e punësimit, nëse ishte më shumë apo më pak se një vit, si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të kërkesave të posaçme për vendin e punës.

Në përfundim të këtyre verifikimeve, **në datën 22.5.2017**, për institucionin e mbikëqyrur, ka përfunduar procedura e deklarin të statusit të punësimit. Me shkresën nr. 1272/2 prot., dt. 25.2.2017 të Departamentit të Administratës Publike, aktet e deklarin i janë përcjellë institucionit të mbikëqyrur, e më pas janë administruar në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil.

Konstatohet se:

- **87 punonjës**, janë deklaruar me statusin e punësimit “*Nëpunës civil*”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, vëmë re se:

- Procedurat e deklarin të statusit të punësimit “*Nëpunës civil*”, janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
- Këta punonjës, në dt. 22.12.2016, ishin të punësuar në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil; kohëzgjatja e periudhës së punësimit ishte më e madhe se një vit dhe plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionin përkatës të punës.

- Në momentin e kryerjes së verifikimit në subjektin e mbikëqyrur 70 punonjës të këtij grupi i vazhdojnë marrëdhëniet e punës me institucionin, ndërsa 17 prej tyre kanë përfunduar marrëdhëniet e punës dhe ato financiare, (12 me dorëheqje, 4 me lirim nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit dhe 1 me masë disiplinore “largim nga shërbimi civil”).

Në mënyrë më të detajuar këto raste janë trajtuar në vijim të materialit, përkatësisht në pikat ku kemi trajtuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet dorëheqjes, largimin nga shërbimi civil si masë disiplinore dhe lirimin nga shërbimi civil si rezultat i mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.

- **27 punonjës**, janë deklaruar me statusin e punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, vëmë re se:

- Procedurat e deklarimit të statusit të punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
- Këta punonjës, në *dt. 22.12.2016*, kanë qenë të punësuar në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil; kohëzgjatja e periudhës së punësimit ishte më e vogël se një vit dhe në 26 raste punonjësit e plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionet përkatëse të punës, ndërsa në 1 rast, nëpunësja \*\*\*\*\*, “*Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm*”, nuk zotëronte titullin “*Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik*”.
- Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes 20 punonjës të këtij grupi i vazhdojnë marrëdhëniet e punës me institucionin, ndërsa 7 prej tyre kanë përfunduar marrëdhëniet e punës dhe ato financiare (6 me dorëheqje, 1 me masë disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”).

Në mënyrë më të detajuar këto raste janë trajtuar në vijim të materialit, përkatësisht në pikat ku kemi trajtuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet dorëheqjes dhe largimi nga shërbimi civil si masë disiplinore.

- **Për 1 punonjës**, është vendosur “*Mospërfitim statusi*”.

Në këtë rast bëhet fjalë për punonjësin \*\*\*\*\*. Sipas listëprezencës së punonjësve për muajin dhjetor 2016, në momentin e përfshirjes së institucionit në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, punonjësi në fjalë ishte i punësuar në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Autorizimit të Pagesave IPARD*”. Njësia përgjegjëse, DAP, me shkresën nr. 1272/3 prot., datë 22.5.2017, “*Njoftim*”, ka bërë me dije institucionin e mbikëqyrur për mospërfitimin e statusit të



punësimi për këtë punonjës, për shkak se emërimi i tij në pozicionin përkatës nuk ishte i përhershëm.

- **Për 4** punonjës, procedurat e deklarimit të statusit të punësimi nuk janë kryer.

Për këta punonjës, është konstatuar se dosjet e personelit nuk ishin plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm, e për këtë arsye kanë përfunduar marrëdhëniet e punës me institucionin. Më konkretisht bëhet fjalë për: \*\*\*\*\*, ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 22.12.2017; \*\*\*\*\*, ka përfunduar marrëdhëniet e punës, në dt. 4.7.2017; \*\*\*\*\*, ka përfunduar marrëdhëniet e punës, në dt. 23.3.2017 dhe \*\*\*\*\*, ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 23.5.2017.

*(Të dhënat që pasqyrojnë realizimin e procedurës së deklarimit të statusit të punësimi, siç janë akti për fillimin e marrëdhënieve të punës, aktet e deklarimit të statusit të punësimi si “Nëpunës civil”, apo “Nëpunës civil në periudhë prove”, të nxjerra në mbështetje të kërkesave të pikës 3 e 4, të nenit 67, të ligjit, për të gjithë ata nëpunës, që në momentin e mbikëqyrjes vazhdojnë marrëdhëniet e punës me institucionin, janë të evidentuara në tabelën nr. 1 që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij).*

## **II. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.**

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, u verifikuan përshkrimet e punës, për të vlerësuar nëse janë respektuar rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 1, datë 31.5.2017 të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë të përcaktuara rastet kur një institucion pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojë përshkrimet e punës, procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen si dhe nëpunësit përgjegjës në këtë proces.

Më konkretisht, vendimi nr. 142, datë 12.3.2014 i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, në kreun IV “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës” (pika 14), përcakton se: “Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.

Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, për periudhën objekt kontrolli, evidentojmë dy momente që kanë diktuar nevojën e hartimit të përshkrimeve të punës.

**Së pari**, fillimi i efekteve juridike të vendimit nr. 877, datë 14.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, që e ka përfshirë institucionin në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Bazuar në përcaktimet e vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, kreu IV “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës”, të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojnë përshkrimet e punës, për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil.

**Së dyti**, ndryshimi i mënyrës së organizimit të institucionit, sipas urdhrit nr. 190, datë 6.11.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave)”, moment kur institucioni u përfshi në proces ristrukturimi.

Në respektim të rregullave të vendosura nga aktet nënligjore si më sipër, subjektet e ngarkuara me përgjegjësinë e hartimit, miratimit e administrimit të përshkrimeve të punës siç janë: njësia e burimeve njerëzore, analisti i punës, eprori direkt i pozicionit respektiv të punës, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe njësia përgjegjëse, duhet të hartonin përshkrimet e punës, për të gjitha pozicionet e shërbimit civil.

Në momentin e kryerjes së verifikimit në institucion, u konstatua se, përshkrimet e punës janë të hartuara sipas formatit që parashikon lidhja 4, bashkëlidhur vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar dhe më tej ato janë miratuar nga eprori direkt i pozicionit përkatës dhe Sekretari i Përgjithshëm sipas përcaktimeve të kreut IV, “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës”, të VKM nr. 142, dt. 12.3.2014, i ndryshuar. Gjithashtu, përshkrimet e punës janë nënshkruar edhe nga nëpunësi civil që punon në pozicionin për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, siç parashikohet në pikën 4.2.10, të udhëzimit nr. 1, datë 31.5.2017 të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Por, nga ana tjetër, në pikën 19 të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, është parashikuar se Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, kthen për rishikim përshkrimet e punës për pozicionet respektive, në rast se vëren se

ato, nuk janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.

Mbështetur në sa parashikohet në këtë dispozitë, nënvizojmë se, e drejta e Departamentit të Administratës Publike, për të rikthyer për rishikim përshkrimet e punës, nënkupton edhe detyrimin e këtij organi për të aprovuar në mënyrë shkresore rregullshmërinë e përshkrimeve të punës. Ky përfundim bazohet edhe në kompetencën e DAP, për administrimin e shërbimit civil, prandaj DAP duhet të njoftojë zyrtarisht institucionin e mbikëqyrur dhe Sekretarin e Pëgjithshëm të ministrisë së linjës, se përshkrimet e punës janë në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u konstatua se, njësia përgjegjëse ka asistuar nëpunësit e ngarkuar për hartimin e përshkrimeve të punës duke iu dhënë orientimet e nevojshme teknike nëpërmjet komunikimit me mjete elektronike dhe në përfundim, përshkrimet e punës janë printuar dhe janë nënshkruar.

Bashkëpunimi në sistemin elektronik, ndërmjet analistit të punës dhe specialistit të DAP-it, ka të bëjë vetëm me fazën krijimit apo hartimit të përshkrimeve të punës që është faza e parë e këtij procesi. Më tej, njësia përgjegjëse jep mendimin lidhur me përputhshmërinë e përshkrimeve të punës me legjislacionin specifik të fushës, apo formatin standard të miratuar dhe në përfundim procesi përmbillet me administrimin e përshkrimeve të punës ku, një kopje e dokumentit përfshihet në dosjen e personelit të çdo nëpunësi, *(në rastin e vendeve të lira një kopje e përshkrimit të punës për secilin pozicion i bashkëngjitet planit të rekrutimit)*, një kopje e përshkrimeve të punës depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike. Në këtë mënyrë përshkrimet e punës bëhen pjesë e akteve rregullative në bazë të të cilave është i organizuar dhe funksionon institucioni, siç janë, struktura dhe organika në fuqi e institucionit, rregullorja e brendshme e institucionit etj.

Kjo për faktin pasi, vetë akti nënligjor, i ka konceptuar këto akte me karakter të qëndrueshëm që hartohen kur krijohen institucione të reja dhe që kushti për t'u ndryshuar është ndryshimi i mënyrës së organizimit të institucionit apo ndryshimi i legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni.

Duhet theksuar se, finalizimi i procesit të hartimit të përshkrimeve të punës ka një rëndësi të veçantë në mirëadministrimin e shërbimit civil dhe në funksionimin normal të institucionit, për arsye se është pikërisht ky akt që përcakton në mënyrë të detajuar funksionet konkrete që do të kryej çdo nëpunës.

Gjithashtu, në këtë akt përcaktohet edhe shkalla e përgjegjësisë, natyra e punës, mjedisi menaxherial, shkalla e vendimmarrjes dhe përcaktime të tjera, të cilat janë të rëndësishme të njihen nga punonjësi, i cili mbulon një pozicion pune pjesë të shërbimit civil.

Hartimi i përshkrimeve të punës, është i rëndësishëm edhe në zbatimin normal të procedurave të tjera që kërkohen nga ligji për nëpunësin civil, të tilla si procedura për vlerësimin e arritjeve në punë apo ecuritë disiplinore. Këto procedura nuk mund të realizohen normalisht në momentin kur nëpunësit nuk i janë përcaktuar në mënyrë të detajuar detyrat dhe përgjegjësitë që ai ka.

Në lidhje me përmbushjen e kërkesave të vendit të punës, nga përmbajtja e aktit të përshkrimit të punës, konstatohet se, në ndarjen *“Kërkesa të posaçme”*, janë përcaktuar kërkesat specifike të vendit të punës në lidhje me nivelin e edukimit dhe fushën kryesore të studimeve; përvojën në punë e përcaktuar në terma kohorë; si dhe njohuritë e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për përmbushjen e detyrave të pozicionit të punës.

Nga të dhënat e administruara, të cilat pasqyrohen në tabelën nr. 2 : *“Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës, për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil”, bashkëlidhur raportit, rezulton se përveç nëpunësit \*\*\*\*\*, e cila nuk ka dorëzuar çertifikatën si “Auditues i brendshëm”, (zotërimi i kësaj çertifikate është kusht i posaçëm i parashikuar nga shkronja “ç”, e nenit 19 të ligjit nr. 114/2015, “Për auditivin e brendshëm në sektorin publik”)*, nëpunësit e tjerë i plotësojnë këto kërkesa.

### **Konkluzion:**

- Procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës është një procedurë administrative, kryerja e së cilës kërkon respektimin e rregullave dhe të afateve të vendosura në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 1, datë 31.5.2017 të Departamentit të Administratës Publike, *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*.
- Institucioni i mbikëqyrur t’i kërkojë Departamentit të Administratës Publike, që të japë zyrtarisht konfirmimin e tij, lidhur me përshkrimet e punës, nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.
- Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse, një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

Sjellim në vëmendje të njësisë përgjegjëse dhe institucionit të mbikëqyrur që, në çdo rast, për procedurat që kanë lidhje me menaxhimin e shërbimit civil, duhet të bëhet administrimi i tyre

edhe në mënyrë shkresore. Administrimi në formë shkresore i procesit është i domosdoshëm jo vetëm si kërkesë e ligjit por edhe me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës si dhe organet e ngarkuara për të kontrolluar zbatimin e ligjit.

### **III. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit të nevojave për rekrutim në shërbimin civil.**

Administrimi i shërbimit civil në bazë të një plani vjetor rekrutimi, është parashikuar në nenin 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Më tej, në mbështetje të kësaj dispozite është miratuar vendimi nr. 108, datë 26.2.2014 i Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, në të cilin janë përcaktuar procedurat e hollësishme për përgatitjen, miratimin, afatin e miratimit dhe mënyrën e bërjes publike të planit vjetor të punësimit.

Mbështetur në procedurat e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, pikat 4, 5, 6 e 7, çdo institucion i administratës shtetërore përgatit planin e nevojave të tij për rekrutim për vitin e ardhshëm dhe e paraqet tek ministri përkatës, jo më vonë se muaji tetor i çdo viti kalendarik. Më pas, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në çdo ministri harton planin e nevojave për rekrutim për aparatin e ministrisë dhe institucionet e varësisë. Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë përkatëse brenda muajit nëntor planin e nevojave për rekrutim, për të gjithë sistemin përkatës, e dërgon në Departamentin e Administratës Publike.

Pra, përgatitja e planit të nevojave për rekrutim është detyrë e institucionit pjesë e shërbimit civil. Por, që ky plan të bëhet pjesë e “Planit vjetor të rekrutimit për institucionet e administratës shtetërore”, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, duhet që të respektohet procedura e dërgimit në formë zyrtare, fillimisht tek ministri përgjegjës, e më pas në Departamentin e Administratës Publike.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, plani i nevojave për rekrutim për vitin 2018 është përgatitur në formë elektronike dhe i është dërguar institucionit qendror, me mjete elektronike.

Me shkresën nr. 460 prot., datë 14.2.2018, lënda “Relacion”, të titullarit të institucionit, i është kërkuar njësisë përgjegjëse DAP, që për disa pozicioneve të kategorisë së ulët drejtuese dhe të barasvlerëshëm, procedura për plotësimin e tyre, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Më pas me vendimin nr. 184, datë 29.3.2018, të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil”, për vitin 2018, i ndryshuar me VKM nr. 266, dt. 16.5.2018, (lidhja nr. 1, bashkëlidhur

VKM), për institucionin e mbikëqyrur është parashikuar që, për 10 pozicione të nivelit të ulët drejtues dhe të barasvlershëm, të mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil.

Më konkretisht bëhet fjalë për pozicionet:

1. Drejtor i Drejtorisë së Financave, kategoria e pagës III-a;
2. Përgjegjës i Sektorit të Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD, kategoria e pagës III-a/1;
3. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit IPARD, kategoria e pagës III-a/1;
4. Përgjegjës i Sektorit të Ekzekutimit të Pagesave IPARD, kategoria e pagës III-a/1;
5. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Skemave, kategoria e pagës III-a/1;
6. Përgjegjës i Sektorit të Promocionit dhe Komunikimit, kategoria e pagës III-a/1;
7. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Skemave Kombëtare, kategoria e pagës III-a/1;
8. Drejtor i Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, kategoria e pagës III-a;
9. Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria e pagës III-a;
10. Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, kategoria e pagës III-a/1.

Sjellim në vëmendje që, njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur si dhe njësia përgjegjëse DAP, duhet të marrin masa dhe të tregojnë kujdes, që procedurat të cilat kanë lidhje me menaxhimin e shërbimit civil dhe janë kryer në mënyrë elektronike, t'i materializojnë edhe në formë shkresore, duke respektuar mënyrën dhe elementët që duhet të përmbajë kopja në letër e dokumentit elektronik, të përcaktuara në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, "*Për nënshkrimin elektronik*", i ndryshuar dhe ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010, "*Për dokumentin elektronik*", i ndryshuar .

Institucioni duhet të tregojë kujdes të posaçëm në përgatitjen e planit të nevojave të tij, për rekrutim pasi, njësia përgjegjëse që në rastin konkret është Departamenti i Administratës Publike, nuk mund të shpallë procedurat e konkurrimit për një pozicion, nëse ai nuk është i pasqyruar në planin vjetor të pranimit, siç parashikohet në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave "*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*".

**IV. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, nga momenti i fillimit të efekteve juridike të aktit nënligjor që e ka përfshirë institucionin në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar e në vijim.**

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, grupi i punës verifikoi emërimet në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur dhe lëvizjes paralele si dhe emërimet në kategorinë e ulët e të mesme drejtuese nëpërmjet lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë.

Konstatohet se, për periudhën objekt mbikëqyrje, nga data 22.12.2016, që është data e fillimit të efekteve juridike të aktit nënligjor që e ka përfshirë institucionin në fushën e veprimit të ligjit

nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar e në vijim, në institucionin e mbikëqyrur janë realizuar:

- **16 emërime**, me procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.
- **1 emërim**, me procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese.
- **3 emërime**, me procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese.

Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur, ka realizuar procedurat e konkurrimit (*DAP-i shpall procedurën e konkurrimit për secilin pozicion duke e publikuar në faqen zyrtare të DAP-it dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”;* krijon Komitetin e Përhershëm të Pranimit për nivelin ekzekutiv; Komitetin e Pranimit për Lëvizjen Paralele; Komitetin e Pranimit për Ngritjen në Detyrë, të cilët bëjnë vlerësimin e kandidatëve) dhe pas përfundimit të procedurave të ankimit, shpall fituesin dhe bën aktin e emërimit të kandidatit të cilin ia njofton kandidatit fitues dhe institucionit.

Në mënyrë më të detajuar konstatojmë si më poshtë:

- Emërime me procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, në institucionin e mbikëqyrur janë kryer 16 emërime, me procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Në mënyrë më të detajuar, nëpunësit e emëruar nëpërmjet kësaj procedure i kemi paraqitur në tabelën si më poshtë:

Emërime në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive:

<b>Nr.</b>	<b>Nëpunësi Emër/ Mbiemër</b>	<b>Pozicioni i punës i plotësuar nëpërmjet pranimit në shërbimin civil</b>	<b>Akti i emërimit i nxjerrë nga DAP-i</b>
1	*****	Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD	Akti nr. 2115, dt. 28.3.2018
2	***** (Larguar me dorëheqje në datën 10.4.2018)	Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD	Akti nr. 2112, dt. 28.3.2018
3	*****	Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD	Akti nr. 2113, dt. 28.3.2018
4	*****	Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes	Akti nr. 2116,

		dhe Aprovimit të Projekteve IPARD	dt. 28.3.2018
5	*****	Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD	Akti nr. 2114, dt. 28.3.2018
6	*****	Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD	Akti nr. 7222, dt. 22.12.2017
7	*****	Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD	Akti nr. 2117, dt. 28.3.2018
8	*****	Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD	Akti nr. 2120, dt. 28.3.2018
9	*****	Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD	Akti nr. 2111, dt. 28.3.2018
10	*****	Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD	Akti nr. 2119, dt. 28.3.2018
11	*****	Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD	Akti nr. 2118, dt. 28.3.2018
12	*****	Specialist në Sektorin e Ekzekutimit të Pagesave IPARD	Akti nr. 2121, dt. 28.3.2018
13	*****	Specialist në Sektorin e Ekzekutimit të Pagesave IPARD	Akti nr. 7221, dt. 22.12.2017
14	*****	Specialist në Sektorin e Riskut, Parandalimit të Mashtrimit, Analizës dhe Raportimit	Akti nr. 2122, dt. 28.3.2018
15	*****	Specialist në Sektorin e Promovimit dhe Komunikimit	Akti nr. 2694, dt. 17.4.2018
16	*****	Specialist në Sektorin e Promovimit dhe Komunikimit	Akti nr. 2695, dt. 17.4.2018

Nisur nga kërkesat ligjore, për këtë kategori specifike të nëpunësve civilë në periudhë prove, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, për nëpunësit si më sipër, duhet të kujdeset për të zbatuar të gjitha detyrimet që parashikon ligji për nëpunësin civil në periudhë prove, të trajtuara në mënyrë të detajuar në pikën IV të projektrapotit.

- *Emërime me procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese.*

Me procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, është bërë **1 emërim**. Në këtë rast bëhet fjalë për:

- ✓ \*\*\*\*\* , Drejtor i Drejtorisë së Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, emëruar në këtë pozicion me akt emërimi të DAP-it nr. 1654 prot., dt. 8.3.2018.
- *Emërime me procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese.*



Me procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, janë bërë **3 emërimet**.

Në këtë rast bëhet fjalë për:

- ✓ \*\*\*\*\*, Përgjegjëse e Sektorit të Përafrimit të Legjislacionit dhe Ndhmës së Huaj, emëruar në këtë pozicion me akt emërimi të DAP-it nr. 6986 prot., dt. 12.12.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*, Përgjegjëse e Sektorit të Autorizimit të Pagesave për Skemat Kombëtare, emëruar në këtë pozicion me akt emërimi të DAP-it nr. 2319 prot., dt. 4.4.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*, Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar në këtë pozicion me akt emërimi të DAP-it nr. 6985, dt. 12.12.2017. (*Me urdhrin nr. 129, dt. 5.3.2018, ka ndërprerë marrëdhënien e punës me institucionin nëpërmjet dorëheqjes*).

### **Konkluzion:**

- Procedurat e pranimit në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, me konkurrim të hapur; plotësimi i vendeve të lira në nivelin e ulët drejtues dhe të barsvlershëm me lëvizje paralele apo nëpërmjet ngritjes në detyrë, janë kryer nga njësia përgjegjëse, që në këtë rast, është Departamenti i Administratës Publike, sikurse përcaktohet në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe vendimin nr. 242, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

### **V. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës, detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe.**

Nëpunësit civil që emërohen për herë të parë në shërbimin civil i nënshtrohen një periudhe prove. Afati i periudhës së provës si dhe detyrat që duhet të përmbushë nëpunësi dhe institucioni përgjatë kësaj periudhe dhe në përfundim të saj, janë të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në kreun VI të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Ndërsa për nëpunësit dhe punonjësit aktualë, që në momentin e përfshirjes së institucionit në skemën e shërbimit civil, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil dhe që periudhën e punësimit në pozicionin përkatës e kishin më të vogël se një vit, bazuar në pikën 4, të nenit 67 të ligjit, për ta zbatohet neni 24 i ligjit dhe periudha e provës për ata fillon nga momenti i përfshirjes së institucionit në fushën e shërbimit civil, (*në dt.22.12.2016*).

Nga verifikimi i listëprezencës së punonjësve për muajin prill 2018, rezulton se aktualisht janë 20 nëpunës, të cilëve periudha e provës iu ka filluar në datën 22.12.2016 dhe iu ka përfunduar në datën 22.12.2017.

- ***Për 16 nëpunës, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, i ka përfunduar procedurat e konfirmimit si nëpunës civil.***

Në mënyrë më të detajuar, procedurat e konfirmimit si nëpunës civil janë përfunduar për nëpunësit:

- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Monitorimit të Skemave;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Monitorimit të Skemave;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Monitorimit të Skemave;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Autorizimit të Pagesave për Skemat Kombëtare;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Ekzekutimit të Pagesave Kombëtare;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Ekzekutimit të Pagesave Kombëtare;
- ✓ \*\*\*\*\*, Përgjegjës i Sektorit Juridik;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist”, në Sektorin Juridik;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist”, në Sektorin Juridik;
- ✓ \*\*\*\*\*, “Specialist”, në Sektorin Auditimit të Brendshëm.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e personelit rezulton se, nëpunësit kanë kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe në përfundim të tij janë vlerësuar me pikë, ku kanë marrë mbi 50 % të pikëve. Nëpunësve iu është bërë vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore. Periudha e provës është përfunduar me nxjerrjen e vendimit të konfirmimit si nëpunës civil për nëpunësit përkatës. Vendimet e konfirmimit i janë njoftuar Departamentit të Administratës Publike me shkresën nr. 706/2 prot., datë 29.3.2018, duke i bashkëlidhur edhe vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe kopje të certifikatës së trajnimit në ASPA.

Referuar faktit që ky institucion u bë pjesë e shërbimit civil me fillimin e efekteve të vendimit nr. 877, datë 14.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin



- ✓ Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të kreut VI, pika 13, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, brenda 10 ditëve, nga marrja e dokumentacionit përkatës nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit të AZHBR-së, duhet të finalizojë procesin e deklarimit të statusit të nëpunësit për nëpunësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*.
- ***Për 3 nëpunës, është vendosur zgjatja njëherë të vetme deri në 6 (gjashtë) muaj e periudhës së provës.***

Më konkretisht, në këtë grupim përfshihen nëpunësit:

\*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare. Me aktin nr. 1272/64 prot., dt. 22.5.2017, të njësisë përgjegjëse i është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin Inspektor në Sektorin e Kontrollit, në Drejtorinë e Kontrollit”.

Vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës i është bërë në nivelin “kënaqshëm” (3).

Me aktin nr. 188/1 prot., dt. 10.2.2018, të titullarit, lënda: “Vendim për shtyerjen e afatit të periudhës së provës të nëpunësit civil”, është vendosur zgjatja e periudhës së provës një herë të vetme, me 2 (dy) muaj, për arsye të raportit mjekësor me kohëzgjatje prej 2 (dy) muajsh dhe mospërfundimit të trajnimit pranë ASPA-s, për të njëjtën arsye.

Në përmbajtjen e aktit nr. 531/55, dt. 15.2.2018 të njësisë përgjegjëse, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, është arsyetuar se, periudha e provës në shërbimin civil për këtë nëpunës, do të vijojë në pozicionin në të cilin transferohet.

Konstatohet se ky nëpunës ka përfunduar kursin e trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civil në periudhë prove, pranë ASPA-s dhe është pajisur me certifikatën me nr: C1.1-01-2018/1, datë 5 mars 2018, vlerësimi 14 pikë nga 28 pikë të mundshme.

**Konkluzion:** Njësia e burimeve njerëzore, në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*, në përfundim të afatit shtesë të periudhës së provës, duhet të marrë masat për të përmbyllur periudhën e provës, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- ✓ Të bëjë vlerësimin e rezultateve individual në punë për periudhën 6 mujore, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore.
- ✓ Të administrojë rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA.

- ✓ Të marrë mendimin me shkrim të nëpunësit civil më të vjetër, nën kujdesin e të cilit ai ka punuar.
- ✓ Eprori direkt i pozicionit “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare, të finalizojë periudhën e provës, me nxjerrjen e aktit individual përkatës, sipas përcaktimeve të kreut VI, të pikës 7, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.
- ✓ Vendimi i eprorit direkt, duhet t’i njoftohet nëpunësit \*\*\*\*\* dhe njësisë përgjegjëse, DAP.
- ✓ Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të kreut VI, pika 13, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të finalizojë këtë proces nëpërmjet nxjerrjes së aktit të deklarimit të statusit të nëpunësit \*\*\*\*\* , brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit të konfirmimit nga eprori direkt.

\*\*\*\*\*, “Specialist”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore. Me aktin nr. 1272/114 prot., dt. 13.6.2017, të njësisë përgjegjëse i është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin Specialist pranë Titullarit të institucionit, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”. Ka përfunduar kursin e trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civil në periudhë prove, pranë ASPA-s dhe është pajisur me çertifikatën me nr: GTAP01-18-2017/11, datë 27 dhjetor 2017, vlerësimi 14 pikë nga 28 pikë të mundshme.

Vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës është bërë në datën 5.1.2018, sipas formularit të vlerësimit të punës për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese. Por, në këtë rast në ndarjen përkatëse, është firmosur vetëm nga zyrtari raportues, (Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore) dhe nga nëpunësi për të cilin është bërë vlerësimi, ndërsa zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues nuk kanë firmosur.

Me aktin nr. 87/19 prot., dt. 16.1.2018, të titullarit, lënda: “Zgjatje e periudhës së provës për nëpunësen \*\*\*\*\*”, është vendosur zgjatja e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 (gjashtë) muaj të tjerë.

Në përmbajtjen e aktit nr. 531/6, dt. 26.1.2018, të njësisë përgjegjëse, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, është arsyetuar se, periudha e provës në shërbimin civil për këtë nëpunës do të vijojë në pozicionin në të cili transferohet.

**Konkluzion:** Njësia e burimeve njerëzore, në rastin e punonjësës \*\*\*\*\* , duhet të marrë masat për të përmbyllur periudhën e provës, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- ✓ Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve individuale në punë për periudhën e provës, duke u vijuar procedura me nënshkrimin e formularit nga zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore.
- ✓ Të administrojë rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA.
- ✓ Të marrë mendimin me shkrim të nëpunësit civil më të vjetër, nën kujdesin e të cilit ajo ka punuar.
- ✓ Eprori direkt i pozicionit “*Specialist*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, të finalizojë periudhën e provës, me nxjerrjen e aktit individual përkatës, sipas përcaktimeve të kreut VI, të pikës 7, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.
- ✓ Vendimi i eprorit direkt, duhet t’i njoftohet nëpunëses \*\*\*\*\* dhe njësisë përgjegjëse, DAP.
- ✓ Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të kreut VI, pika 13, të VKM nr. 243, date 18.3.2015, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të finalizojë këtë proces nëpërmjet nxjerrjes së aktit të deklarimit të statusit të nëpunësit \*\*\*\*\* , brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit të konfirmimit nga eprori direkt.

**Andrea Miha**, “*Specialist*”, në Sektorin e Përafrimit të Legjislacionit dhe Ndihmës së Huaj. Me aktin nr. 1272/111 prot., dt. 13.6.2017, të njësisë përgjegjëse i është deklaruar statusi i punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin Specialist në Sektorin e Integritit dhe Harmonizimit të Procedurave*”.

Ka përfunduar kursin e trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civil në periudhë prove, pranë ASPA-s dhe është pajisur me certifikatën me nr: GTAP01-18-2017/04, datë 27 dhjetor 2017, vlerësimi 17 pikë nga 28 pikë të mundshme.

Vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës “*jokënaqshëm*” (4), është bërë nga titullari i institucionit. Nënshkrimi i titullarit (zyrtarit autorizues) në datë 15.1.2018, nënshkrimi i nëpunësit në datë 2.2.2018. (*Përgjegjësi i Sektorit të Integritit & Harmonizimit të Procedurave \*\*\*\*\* dhe drejtori i Drejtorisë Juridike & Shërbimev Mbështetëse \*\*\*\*\* , janë emëruar nga DAP, në dt. 12.12.2017*).

Me aktin nr. 87 prot., dt. 10.1.2018, të titullarit, lënda “*Mbi shtyrjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë, nëpunësit civil në periudhë prove \*\*\*\*\**”, është

vendosur zgjatja e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 (*gjashtë*) muaj të tjerë, për arsye të vlerësimit “*jokënaqshëm*” (4).

Në këtë rast, nëpunësi nuk ka qenë dakord me vlerësimin e për këtë arsye është ankuar në mënyrë shkresore tek Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Titullari i institucionit. (*Ankim administrativ nr. 306 prot., dt. 1.2.2018*). Ankimi i është dërguar për dijeni edhe Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se Titullari i institucionit nuk e ka shqyrtuar ankimin, ndërsa pozicioni Drejtor i Drejtorisë së Financës është vend i lirë pasi ky pozicion mbahej nga nëpunësja \*\*\*\*\*, e cila me aktin nr. 495, dt. 15.2.2018 të DAP, është transferuar në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Ekzekutimit të Pagesave, për shkak të ristrukturimit.

Në këtë rast, titullari i institucionit duhet të shqyrtojë ankimin e paraqitur nga nëpunësi, lidhur me vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë, pasi një detyrim i tillë është i parashikuar në pikat 1 e 2, të kreut V, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, ku në mënyrë të shprehur thuhet se:

1. “*Nëpunësi civil i kategorisë ekzekutive, të ulët ose të mesme drejtuese, kur nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë, ka të drejtë të kërkojë shqyrtimin e vlerësimit nga Sekretari i Përgjithshëm/ pozicioni i barasvlershëm me të/ titullari i institucionit.*”
2. *Zyrtari autorizues, brenda 5 (pesë) ditëve, shqyrton ankimin dhe bën vlerësimin përkatës, i cili shënohet dhe nënshkruhet nga ky i fundit në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë”.*

#### **Konkluzion:**

- Titullari i AZHBR-së të shqyrtojë ankimin e nëpunësit \*\*\*\*\* , siç parashikohet në pikën 2, të kreut V, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar.
- Të njoftohet nëpunësi lidhur me përfundimin e veprimeve administrative të kryera në këtë rast.
- Njësia e burimeve njerëzore e institucionit të AZHBR-së të përmbyllë procesin e konfirmimit të nëpunësit \*\*\*\*\* , në përputhje me përcaktimet e pikës 3, të nenit 24 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe kreut VI, pika 6, e në vijim,

të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

\*\*\*\*\*, “Specialist”, në Sektorin Auditimit të Brendshëm. Me aktin nr. 1272/83 prot., dt. 22.5.2017, të njësisë përgjegjëse i është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm”. Ka përfunduar kursin e trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civil në periudhë prove, pranë ASPA-s dhe është pajisur me certifikatën me nr: GTAP01-18-2017/22, datë 27 dhjetor 2017, rezultati i vlerësimit 25/28 pikë të mundshme.

Vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës është bërë në nivelin “shumë mirë” (1). Vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës është bërë nga \*\*\*\*\* me detyrë “Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm”. Titullari i institucionit nuk ka qenë dakord me vlerësimin në nivelin “shumë mirë” (1) dhe mosdakordësinë e ka arsyetuar me shkrim në ndarjen “DH” me titull: “Rivlerësimi nga zyrtari autorizues”. Por pikat 2 dhe 3, të kësaj ndarje nuk janë plotësuar nga nëpunësi, e për këtë arsye procedura e vlerësimit nuk mund të konsiderohet e përfunduar.

Konstatohet se, Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm, \*\*\*\*\* nga data 4 shtator 2017 deri në datën 15 mars 2018, ka qenë me leje lindje. Në momentin e largimit, përgjegjësjë e sektorit nuk ka bërë një vlerësim paraprak për nëpunësin në periudhë prove, detyrë kjo e përcaktuar në pikën 9, të kreut VI, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Më konkretisht, kjo dispozitë përcakton se:

*“Në rast se gjatë periudhës së provës eprori direkt apo nëpunësi më i vjetër largohet nga ai pozicion pune apo ndodhet në pamundësi të vazhdimt të mëtejshëm të detyrës, ai është i detyruar të bëjë një vlerësim paraprak për nëpunësin në periudhë prove”.*

Bazuar në përcaktimet e shkronjës “b”, të pikës 6, të kreut VI, të VKM nr. 243, dt. 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, vlerësimi i rezultateve individuale në punë për periudhën e provës, bëhet sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për vlerësimin e arritjeve vjetore.

Referuar VKM nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, kreu 1, pika 2/b “Zyrtar raportues”, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative nëpunësin që do të vlerësohet. Në rastin në fjalë, në kushtet kur përgjegjësi i sektorit ishte me leje lindje, bazuar në strukturën organizative në fuqi, në cilësinë e nëpunësit që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative paraqitet titullari i institucionit, pasi Sektori i Auditimit të Brendshëm, ka varësi direkte nga titullari i institucionit.



Njësia e burimeve njerëzore e institucionit sqaroi grupin e punës se, gjatë kohës që Përgjegjësjë e Sektorit të Auditimit të Brendshëm ishte me leje lindje, detyrat e saj janë kryer nga \*\*\*\*\*\*, specialiste në këtë sektor. Ky zëvendësim është bërë në bazë të “Listës së planit të zëvendësimit në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, me nr. 94 prot., dt. 18.1.2016. Kjo praktikë pune nuk është në përputhje me parashikimet e shkronjës “b”, të pikës 2, të VKM nr. 109, dt. 26.2.2014, ku në mënyrë të shprehur përcaktohet se, “Zyrtar raportues”, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative nëpunësin që do të vlerësohet.

Duke qenë se nëpunësja, \*\*\*\*\*\*, ka paraqitur një kërkesë/informacion pranë Komisionerit, të regjistruar, me nr. 179 prot., datë 23.1.2018, ku pretendon për parregullsi lidhur me mënyrën e zbatimit të ligjit gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës, si dhe marrjes së vendimit në përfundim të kësaj periudhe, ky rast është trajtuar në pikën X të raportit, me titull “Kërkesa/Informacione të paraqitura nga nëpunës të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), nënpika X.1, me titull “Kërkesa e datës 22.1.2018, protokolluar me nr. 179 prot., date 23.1.2018, e paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, në AZHBR”.

#### - *Nëpunës civil në periudhë prove*

Konstatohet se, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, janë **15 nëpunës civil**, të emëruar për herë të parë në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive. Bazuar në përcaktimet e pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar këta nëpunës i nënshtrohen periudhës së provës që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit. Në mënyrë të shprehur, kjo dispozitë përcakton se:

*“Nëpunësi, që emërohet për herë të parë në shërbimin civil, i nënshtrohet një periudhe prove që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit”.*

Në këtë rast, bëhet fjalë për nëpunësit:

- ✓ \*\*\*\*\*\*, Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2115, dt. 28.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2113, dt. 28.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2116, dt. 28.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2114, dt. 28.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 7222, dt. 22.12.2017.

- ✓ \*\*\*\*\*\*, Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2117, dt. 28.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2120, dt. 28.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2111, dt. 28.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2119, dt. 28.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2118, dt. 28.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Ekzekutimit të Pagesave IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2121, dt. 28.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Ekzekutimit të Pagesave IPARD, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 7221, dt. 22.12.2017.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Riskut, Parandalimit të Mashtrimit, Analizës dhe Raportimit, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2122, dt. 28.3.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Promovimit dhe Komunikimit, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2694, dt. 17.4.2018.
- ✓ \*\*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Promovimit dhe Komunikimit, emëruar në shërbimin civil me aktin nr. 2695, dt. 17.4.2018.

Mbështetur në parashikimet e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, sjellim në vëmendje të aktorëve përgjegjës për këtë proces që, për nëpunësit civil në periudhë prove, duhet të kenë parasysh këto detyra ligjore:

- Nëpunësi është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA) dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.
- Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër, nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe vendimin për përfundimin e periudhës së provës. Vlerësimi i rezultateve individuale në punë për periudhën e provës, bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore. Por në rastin e vlerësimit për periudhën e provës, periudha e vlerësimit fillon nga data e aktit të emërimit dhe zgjat një vit. Për këtë arsye, në formularin e vlerësimit të punës, në “Ndarja A”, duhet të përzgjidhet rasti “Tjetër (specifiko)” duke shënuar “Vlerësim i rezultateve në punë për periudhën e provës”.

- Njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur duhet që, në çdo rast të përfundimit të periudhës së provës, vendimin e eprorit direkt t'ia njoftojë njësisë përgjegjëse (DAP), e cila në zbatim të pikën 13, të kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, nxjerr aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni përkatës.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës.

*(Për nëpunësit që kanë përfunduar periudhën e provës, të dhënat lidhur me: kryerjen e ciklit të trajnimit pranë ASPA-s; vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës; si dhe, akti i konfirmimit si nëpunës civil, janë pasqyruar në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij).*

**VI. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste, (ristrukturimi, ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin si dhe rastet e tjera të transferimit).**

Kriteret bazë mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të transferimit të nëpunësit civil në një pozicion tjetër të shërbimit civil, (*transferimi i përkohshëm, arsyet e transferimit, kohëzgjatja e transferimit, transferimi i përhershëm, rastet kur zbatohet transferimi i përhershëm, transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*), janë përcaktimet e kreut VIII “*Transferimi në shërbimin civil*”, nenet nga 48 deri në 52, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar; vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përkrahimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar si dhe udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016 të Departamentit të Administratës Publike “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, i ndryshuar.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin e AZHBR-së, u konstatua se:

Për periudhën objekt mbikëqyrje është zbatuar vetëm transferimi për shkak të ristrukturimit të institucionit, i parashikuar nga neni 50, i ligjit.

Ndërsa, transferimi i përkohshëm; transferimi i përhershëm për arsye të paaftësisë shëndetësore; transferimi i përhershëm për shmangien e konfliktit të interesit si dhe transferimi në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit nëse pozicioni i mëparshëm i punës

është plotësuar përfundimisht, të parashikuar nga nenet 48, 51, 52 dhe pika 1, e nenit 56, të ligjit, për periudhën e mbikëqyrur nuk janë aplikuar në asnjë rast.

- ***Transferimi për shkak të ristrukturimit të institucionit, apo ndryshimit të mënyrës së organizimit të institucionit:***
  - *Ristrukturimi i institucionit të AZHBR së.*

Nga verifikimi i tërësisë së materialeve shkresore të vëna në dispozicion, si dhe vlerësimit të tyre në raport me ligjin, vemë re, se:

Me urdhrin nr. 190, datë 6.11.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), është miratuar struktura dhe organika e re e institucionit. Në pikën 3 të këtij urdhri, është përcaktuar numri i punonjësve të AZHBR-së, *gjithsej 133 veta*. Gjithashtu, urdhri për miratimin e strukturës së re, ka shfuqizuar strukturën dhe organikën e mëparshme të institucionit, të miratuar me urdhrin nr. 156, datë 1.12.2015, të Kryeministrit.

Duke krahasuar strukturën e vjetër me strukturën e re, rezulton se ***numri i përgjithshëm i vendeve të punës ishte 123 dhe është bërë 133***, pra janë shtuar 10 vende pune.

Konstatohet se në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së re, disa njësi pjesë përbërëse të institucionit të organizuara si sektor, janë riorganizuar. Më konkretisht, vërehet se janë riorganizuar këta sektorë:

- “Sektori i Përzgjedhjes & Aprovimit të Projekteve IPARD”, (ishte 1 + 7, është bërë 1 + 16);
- “Sektori i Përzgjedhjes & Aprovimit të Projekteve Kombëtare”, (ishte 1 + 6, është bërë 1 + 4);
- “Sektori i Kontrollit IPARD”, (ishte 1 + 8, është bërë 1 + 11);
- “Sektori i Kontrollit”, ishte 1 + 33, ka ndryshuar emërtesën duke u bërë “Sektori i Kontrollit të Skemave Kombëtare”, (ishte 1 + 33, është bërë 1 + 32);
- “Sektori i Autorizimit të Pagesave IPARD”, (ishte 1 + 3, është bërë 1 + 4);
- “Sektori i Autorizimit të Pagesave për Skemat Kombëtare”, (ishte 1 + 3, është bërë 1 + 2);
- “Sektori i Kontabilitetit”, (ishte 1 + 2, është bërë 1 + 3);
- “Sektori Juridik”, (ishte 1 + 5, është bërë 1 + 4);
- “Sektori i Burimeve Njerëzore” (ishte 1 + 4, është bërë 1 + 3);
- “Sektori i Teknologjisë së Informacionit”, (ishte 1 + 4, është bërë 1 + 2);
- “Sektori i Integritetit dhe Harmonizimit të Procedurave” është shkrirë, dhe janë krijuar dy sektorë të ri me emërtesën “Sektori i Promocionit dhe Komunikimit” dhe “Sektori i Përafrimit të Legjislacionit dhe Ndhmës së Huaj”.

- Pozicioni “Specialist”, pranë titullarit të institucionit që e kishte struktura e vjetër, në strukturën e re nuk është parashikuar.

Pra, 11 vende pune të strukturës së vjetër nuk ekzistojnë më, ndërkohë janë krijuar 20 pozicione pune të reja. Ndërsa në total, struktura e re, ka 9 pozicione të shërbimit civil më shumë se struktura e vjetër.

Mënyra e organizimit të pozicioneve të shërbimit civil sipas strukturës së re krahasuar me strukturën e vjetër, paraqitet sipas tabelës më poshtë:

<b>Emërtesa e pozicioneve të punës sipas emërtesës.</b>	<b>Numri i pozicioneve të punës, sipas strukturës së vjetër.</b>	<b>Numri i pozicioneve të punës, sipas strukturës së re.</b>
Titullar i institucionit	1	1
Drejtor Drejtorie	6 pozicione, kategoria e pagës III-a	6 pozicione, kategoria e pagës III-a
Përgjegjës Sektori	18 pozicione, kategoria e pagës III-a/1	19 pozicione, kategoria e pagës III-a/1
Inspektor	69 pozicione, kategoria e pagës III-b	78 pozicione, kategoria e pagës III-b
Specialist	27 pozicione, kategoria e pagës IV-a	26 pozicione, kategoria e pagës IV-a
Sekretar	0	1
Punonjës Pastrimi	1	1
Shofer	1	1
<b>Pozicione pune të miratuara gjithsej</b>	<b>123</b>	<b>133</b>

Pas miratimit të strukturës dhe organikës së re, njësia e burimeve njerëzore, nëpërmjet komunikimit elektronik, (*nëpërmjet email zyrtar*), ka njoftuar nëpunësit e institucionit për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit të institucionit.

### ***Konkluzion:***

- Konkludohet se institucioni i AZHBR-së, ka kaluar në proces ristrukturimi, në kushtet kur konstatohet plotësimi i kërkesave ligjore për të patur një proces të tillë: **a)** disa njësi të organizuara në nivel sektori, janë riorganizuar; **b)** janë shtuar vendet e punës pjesë e shërbimit civil; **c)** për kryerjen e funksioneve administrative të institucionit është bërë e nevojshme një rishpërndarje e burimeve njerëzore.

- *Krijimi i Komisionit të Ristrukturimit.*

Pas hyrjes në fuqi të strukturës dhe organikës së re, Departamenti i Administratës Publike, me urdhrin nr. 123 prot, datë 7.12.2017, *“Për krijimin e komisionit të ristrukturimit, në kuadër të ristrukturimit të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave)”*, ka krijuar komisionin e ristrukturimit të përbërë nga:

- \*\*\*\*\*\*, Përgjegjës i Sektorit të Sekretariatit Teknik për TND, në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit në Fushën e Menaxhimit të Shërbimit Civil, në Departamentin e Administratës Publike - kryetar.
- \*\*\*\*\*\*, Përgjegjës i Sektorit të Riskut, Parandalimit, Analizës dhe Raportimit, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave) - anëtar. *(në këtë moment Pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm, ishte bërë objekt gjykimi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me regjimin juridik të këtij pozicioni, ndërsa pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, ishte vend i lirë).*
- \*\*\*\*\*\*, Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - anëtar. *(Caktimi i nëpunëses në fjalë si përfaqësuese e MBZHR, në komisionin e ristrukturimit është bërë me autorizim të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR, shkresa nr. 8883/1 prot., datë 6.12.2017).*

### **Konkluzion:**

Nga sa analizuam më sipër, vlerësojmë se, komisioni i ristrukturimit është krijuar në përputhje me kërkesat e përcaktuar në pikat 3 e 4, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar; pikat 16 e 17, të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016 të Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit, për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit”*, i ndryshuar.

- *Propozimi i Komisionit të Ristrukturimit për transferimi i nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit.*

Komisioni i ristrukturimit pasi ka analizuar organikën e vjetër dhe organikën e re të institucionit, ka evidentuar pozicionet e punës të cilat prekeshin nga ristrukturimi si dhe nëpunësit e punësuar në këto pozicione. Më pas, është vijuar me verifikimin e plotësimit të kërkesave të posaçme të parashikuara për çdo pozicion të lirë apo të krijuar me të dhënat individuale të nëpunësve në pritje për transferim.

Në përfundim të procedurave të verifikimit, Komisioni ka vendosur si më poshtë:

- Për **42 nëpunës**, është propozuar transferimi në pozicione pune të së njëjtës kategori.

Në këtë rast, Komisioni i Ristrukturimit, ka vepruar në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 50 të ligjit, ku parashikohet se: *“Nëse për shkak të mbylljes apo restrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori”*.

- Për **8 nëpunës**, është propozuar transferimi në pozicione pune të një kategorie më të ulët.

Në këtë rast bëhet fjalë për nëpunësit:

- \*\*\*\*\*, *“Përgjegjës i Sektorit të Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD”*, kategoria e pagës III-a/1, është propozuar të transferohet në pozicionin *“Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD”*, kategoria e pagës III-b.
- \*\*\*\*\*, *“Përgjegjës i Sektorit të Autorizimit të Pagesave IPARD”*, kategoria e pagës III-a/1, është propozuar të transferohet në pozicionin *“Inspektor në Sektorin e Menaxhimit të Borxhit”*, kategoria e pagës III-b.
- \*\*\*\*\*, *“Përgjegjës i Sektorit të Autorizimit të Pagesave për Skemat Kombëtare”*, kategoria e pagës III-a/1, është propozuar të transferohet në pozicionin *“Inspektor në Sektorin e Monitorimit të Skemave”*, kategoria e pagës III-b.
- \*\*\*\*\*, *“Përgjegjës i Sektorit të Ekzekutimit të Pagesave IPARD”*, kategoria e pagës III-a/1, është propozuar të transferohet në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Përfafritimit të Legjislacionit dhe Ndihmës së Huaj”*, kategoria e pagës IV-a.
- \*\*\*\*\*, *“Përgjegjës i Sektorit të Ekzekutimit të Pagesave Kombëtare”*, kategoria e pagës III-a/1, është propozuar të transferohet në pozicionin *“Inspektor në Sektorin e Ekzekutimit të Pagesave Kombëtare”*, kategoria e pagës III-b.
- \*\*\*\*\*, *“Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit IPARD”*, kategoria e pagës III-a/1, është propozuar të transferohet në pozicionin *“Inspektor në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare”*, kategoria e pagës III-b.
- \*\*\*\*\*, *“Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Skemave”*, kategoria e pagës III-a/1, është propozuar të transferohet në pozicionin *“Inspektor në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare”*, kategoria e pagës III-b.
- \*\*\*\*\*, *“Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit”*, kategoria e pagës III-a/1, është propozuar të transferohet në pozicionin *“Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD”*, kategoria e pagës III-b.

Duke analizuar materialin propozues të Komisionit të Ristrukturimit, vihet re se, sistemimi i këtyre punonjësve në pozicione të shërbimit civil të një niveli më të ulët, është bërë me arsyetimin se, në përshkrimet e reja të punës kanë ndryshuar kërkesat e posaçme, lidhur me nivelin e diplomës dhe profilin e arsimit të lartë.

Në këtë rast, Komisioni i Ristrukturimit ka marrë miratimin me shkrim të nëpunësve, ku ata janë shprehur, se e pranojnë transferimin e përhershëm në një pozicion të një kategorie më të ulët, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit.

Vendimet propozuese të Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e nëpunësve civil për shkak të ristrukturimit, janë pasqyruar në shkresat nr. 224 prot., dt. 25.1.2018 dhe nr. 362 prot., dt. 6.2.2018 “*Vendim i Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave) për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civil në kuadër të ristrukturimit*”, si dhe në shkresën “*Arsyetimi i Komisionit të Ristrukturimit, për transferimin e nëpunësve civil në kuadër të ristrukturimit*”.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, pasi ka marrë në shqyrtim propozimet e bëra nga Komisioni, me shkresat nr. 531/1 prot., dt. 26.1.2018 “*Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural*”; nr. 531/55, dt. 15.2.2018 dhe nr. 495, dt. 15.12.2018, ka miratuar propozimet e bëra nga Komisioni. Më tej, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, i ka njoftuar çdo nëpunësi vendimin përfundimtar të transferimit, të marrë nga njësia përgjegjëse.

*(Vendimet përfundimtare të marra nga Departamenti i Administratës Publike, për transferimin e nëpunësve për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, janë të evidentuara në tabelën nr. 1: “Nëpunës të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, në institucionin e AZHBR-së”, që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij).*

- *Raste të përfudnimit të marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit.*

Nga verifikimet e kryera rezulton se, për **4 nëpunës civilë**, Komisioni i Ristrukturimit të AZHBR-së, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në këtë rast bëhet fjalë për:

\*\*\*\*\*, “*Inspektor në Sektorin e Kontrollit*”, në Drejtorinë e Kontrollit, me vendimin nr. 275 prot., datë 30.1.2018 të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak se sipas përshkrimit të ri të vendit të punës, nuk plotëson kërkesat e posaçme lidhur me profilin e arsimit të lartë që ai zotëron. Ky punonjës



zotëron diplomë Master i Shkencave në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, Specialiteti Këmbësori. Në përshkrimin e ri të punës të hartuar për këtë pozicion, në ndarjen XII “Kërkesat e posaçme” – Arsimi – është parashikuar: Arsimi i lartë universitar, me profil bujqësor/ agrar/ ekonomik/ financë/ inxhinieri mjedisi/ inxhinieri ndërtimi/ drejtësi. Diploma “Bachelor” dhe “Master profesional”/ “Master shkencor” në këto fusha.

Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, bazuar në propozimin e komisionit të ristrukturimit, me urdhrin nr. 79, dt. 1.2.2018, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për punonjësin Nikollaq Deçka, të cilin më pas ia ka njoftuar nëpunësit dhe njësisë përgjegjëse.

Nëpunësit të liruar nga shërbimi civil, në përputhje me eksperiencën në punë si nëpunës civil, i është njohur e drejta e dëmshpërblimit sipas përcaktimeve të pikës 7, shkronja “b”, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nëpunësi \*\*\*\*\* i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranë kësaj gjykate është regjistruar për gjykim çështja administrative nr. 2028 akti, viti 2018, me objekt ankimi: Shfuqizimin e aktit administrativ, nr. 275 prot., datë 30.1.2018 të Komisionit të Ristrukturimit, pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural si dhe akteve që kanë dalë më pas për ndërprejn e marrëdhënieve të punës. Çështja është në shqyrtim pranë gjykatës.

\*\*\*\*\*, “Inspektor në Sektorin e Kontrollit”, në Drejtorinë e Kontrollit, me vendimin nr. 276 prot., datë 30.1.2018 të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak se sipas përshkrimit të ri të vendit të punës, nuk plotëson kërkesat e posaçme lidhur me profilin e arsimit të lartë që ai zotëron. Ky punonjës zotëron diplomë Master i Shkencave në Akademinë e Forcave Tokësore “Skënderbej”, specialiteti “Xhenio”. Në përshkrimin e ri të punës të hartuar për pozicionin “Inspektor në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare”, në ndarjen XII “Kërkesat e posaçme” – Arsimi – është parashikuar: Arsimi i lartë universitar, me profil bujqësor/ agrar/ ekonomik/ financë/ inxhinieri mjedisi/ inxhinieri ndërtimi/ drejtësi. Diploma “Bachelor” dhe “Master profesional”/ “Master shkencor” në këto fusha.

Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, bazuar në propozimin e komisionit të ristrukturimit, me urdhrin nr. 81, dt. 1.2.2018, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për punonjësin \*\*\*\*\* i, të cilin më pas ia ka njoftuar nëpunësit dhe njësisë përgjegjëse.

Nëpunësit të liruar nga shërbimi civil, në përputhje me eksperiencën në punë si nëpunës civil, i është njohur e drejta e dëmshpërblimit sipas përcaktimeve të pikës 7, shkronja “b”, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nëpunësi \*\*\*\*\* i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranë kësaj gjykate është regjistruar për gjykim çështja administrative nr. 2237 akti,

datë 6.4.2018, me objekt: Shfuqizimin tërësisht të aktit nr. 312, datë 1.2.2018, për lirimin nga shërbimi civil në kuadër të ristrukturimit. Çështja është në shqyrtim pranë gjykatës.

\*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së Ekzekutimit të Pagesave”, në AZHBR, me vendimin nr. 277 prot., datë 30.1.2018 të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak se sipas përshkrimit të ri të vendit të punës, nuk plotëson kërkesat e posaçme lidhur me profilin e arsimit të lartë që ajo zotëron. Kjo punonjëse zotëron diplomë DIND në degën “Gjeografi”, Fakulteti i Histori-Filologjisë, UT; Diplomë “Master profesional” në degën “Teknologji të Avancuara në Hortikulturë”, në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, UBT; “Master profesional” në degën “Ekonomi dhe Agrobiznes”, profili “Ekonomi dhe Politikë Agrare”, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, UBT. Në përshkrimin e ri të punës të hartuar për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Ekzekutimit të Pagesave”, në ndarjen XII “Kërkesat e posaçme” – Arsimi – është parashikuar: Arsimi i lartë universitar, në shkenca ekonomike, në profilin ekonomiks/ financë/ kontabilitet/ financë-bankë, cikël i plotë studimesh të nivelit të dytë DIND, “Master shkencor” dhe “Bachelor” të jenë në të njëjtën fushë.

Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, bazuar në propozimin e komisionit të ristrukturimit, me urdhrin nr. 80, dt. 1.2.2018, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për punonjësen \*\*\*\*\* , të cilin më pas ia ka njoftuar nëpunëses dhe njësisë përgjegjëse.

Nëpunëses së liruar nga shërbimi civil, në përputhje me eksperiencën në punë si nëpunës civil, i është njohur e drejta e dëmshpërblimit sipas përcaktimeve të pikës 7, shkronja “b”, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nëpunësja \*\*\*\*\* , nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr. 340 prot., datë 15.3.2018, ka vënë në dijeni Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për shkelje të pretenduara në lidhje me lirimin e saj nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit. Por, për parregullsitë e pretenduara në lidhje me veprimet e kryera për lirimin nga shërbimi civil, ajo para se ti drejtohej Komisionerit, ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranë kësaj gjykate është regjistruar për gjykim çështja administrative nr. 1718 akti, datë 20.2.2018. Çështja është në shqyrtim pranë gjykatës.

\*\*\*\*\*, “Drejtor i Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave”, në AZHBR, me vendimin nr. 652 prot., datë 28.2.2018 të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak se sipas përshkrimit të ri të vendit të punës, nuk plotëson kërkesat e posaçme lidhur me profilin e arsimit të lartë që ai zotëron. Ky punonjës zotëron diplomë DIND në degën “Inxhinieri Agrare” profili “Prodhim Bimor”, në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, UBT. Në përshkrimin e ri të punës të hartuar për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave”, në ndarjen XII “Kërkesat e posaçme” – Arsimi – është parashikuar: Arsimi i lartë universitar, Diplomë e nivelit të dytë (DIND) në shkenca ekonomike,

në profilin Ekonomiks, Financë - Kontabilitet ose cikël i plotë studimesh, “*Bachelor*” dhe “*Master shkencor*” (MSC), në të njëjtën fushë.

Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, bazuar në propozimin e komisionit të ristrukturimit, me urdhrin nr. 128, dt. 5.3.2018, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për punonjësin \*\*\*\*\*; të cilin më pas ia ka njoftuar nëpunësit dhe njësisë përgjegjëse.

Nëpunësit të liruar nga shërbimi civil, në përputhje me eksperiencën në punë si nëpunës civil, i është njohur e drejta e dëmshpërblimit sipas përcaktimeve të pikës 7, shkronja “b”, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Nëpunësi \*\*\*\*\*; nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr. 323 prot., datë 9.3.2018, ka vënë në dijeni Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për shkelje të pretenduara në lidhje me lirimin e tij nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit. Por, për parregullsitë e pretenduara në lidhje me veprimet e kryera për lirimin nga shërbimi civil në kuadër të ristrukturimit, ai i është drejtuar me padi edhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranë kësaj gjykate është regjistruar për gjykim çështja administrative nr. 1718 akti, datë 20.2.2018. Çështja është në shqyrtim pranë gjykatës.

Bazuar në faktet e përmendura si më sipër, rezulton se nëpunësit \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*; kundër akteve të lirimit nga shërbimi civil, janë ankuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ky fakt provohet me fletëthirrjet që gjykata i ka dërguar institucionit të mbikëqyrur dhe kërkesëpaditë bashkëlidhur tyre. Më konkretisht:

- Çështja administrative me paditës \*\*\*\*\*; shkresa dt. 13.3.2018 “*Njoftimi i kërkesëpadisë dhe akteve shoqëruese të saj*”.
- Çështja administrative me paditës \*\*\*\*\*; njoftim nr. 1111 prot., dt. 11.4.2018, (Nr. 2237 akti, dt. 6.4.2018).
- Çështja administrative me paditës \*\*\*\*\*; shkresa nr. 2407 Regjistri Themeltar, datë 18.4.2018, “*Njoftim për seancën përgatitore dhe caktimi i afatit për plotësimin e detyrimit ligjor sipas nenit 25/b, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”.
- Çështja administrative me paditës \*\*\*\*\*; fletëthirrje nr. Akti 1718, dt. 20.2.2018.

Në këto kushte, referuar parimit të sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, dt. 29.3.1996, “*Kodi i Procedurës Civile*”, i ndryshuar, sipas të cilit, institucionet e tjera shtetërore nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se këto çështje do të marrin zgjidhje përfundimtare pas përfundimit të procesit gjyqësor, ku do të vlerësohet situata. Në këtë kuadër, ndër të tjera, gjykata do të shprehet edhe për rregullshmërinë e lirimit nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit.

**VII. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e komisionit të përhershëm).**

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u verifikuan procedurat administrative disiplinore të realizuara nga institucioni përgjatë periudhës objekt mbikëqyrje, (nga momenti i përfshirjes së institucionit në fushën e veprimt të ligjit për nëpunësin civil deri në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes).

Shkelja e detyrimeve që e ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin civil, llojet e shkeljeve dhe masave disiplinore, organi kompetent disiplinor dhe procedurat që duhet të ndiqen në një procedim disiplinor janë të përcaktuara në kreun X “Disiplina në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nenet nga 57 deri në 61; në vendimin nr. 115, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar me VKM nr. 437, dt. 18.7.2018, si dhe udhëzimin nr. 1, datë 2.4.2014 të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe material të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Konstatohet se, për periudhën objekt mbikëqyrje janë proceduar me masë disiplinore **4 nëpunës**.

Duke patur parasysh klasifikimin që i është bërë shkeljes disiplinore të pretenduar, konstatohet se:

➤ **2 procedura** disiplinore janë realizuar për “shkelje të lehta”.

Në këto raste, është aplikuar masa disiplinore “Vërejtje”, e parashikuar nga shkronja “a”, e nenit 58, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Masa disiplinore “Vërejtje”, është zbatuar ndaj nëpunësve:

- \*\*\*\*\*\*, “Inspektor”, në Sektorin e Autorizimit të Pagesave për Skemat Kombëtare, Drejtoria e Autorizimit të Pagesave. (Vendim nr.1, datë 7.7.2017, i Drejtorit të Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave”.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*\*, është zbatuar masa disiplinore “Vërejtje”, e parashikuar nga shkronja “a”, e nenit 58, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Masa disiplinore është marrë për sjellje të parregullt gjatë kohës së punës me eprorët, e parashikuar nga shkronja “c”, e pikës 4, të nenit 57 të ligjit. Nëpunësi nuk e ka ankimuar masën disiplinore, në rrugë administrative dhe gjyqësore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion vihet re se, në lidhje me vendim nr.1, datë 7.7.2017, të Drejtorit të Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, për marrje mase disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*\*, nuk ka një vendim për klasifikimin e shkeljes

disiplinore, nga ana e eprorit direkt sipas pikës 1, të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Po kështu, nuk provohet që eprori direkt të ketë njoftuar me shkrim nëpunësin për shkeljen disiplinore të pretenduar, si dhe nuk provohet që të jetë caktuar një datë për shqyrtimin e shkeljes disiplinore të pretenduar, apo të jetë dëgjuar nëpunësi për të dhënë shpjegime rreth faktit të pretenduar si shkelje disiplinore.

Sjellim në vëmendje të organit disiplinor, në këtë rast të eprorit direkt se, kur arrihet në përfundimin për të filluar një ecuri disiplinore ndaj një nëpunësi civil, është e detyrueshme të respektohen procedurat e parashikuara në pikën 13, të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, të cilat i garantojnë nëpunësit të drejtën për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit; për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar; si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar.

Për sa u përket më sipër, vlerësojmë se vendimi nr.1, datë 7.7.2017, i Drejtorit të Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, për marrje mase disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\* , në vështrim të nenit 108, të Kodit të Procedurave Administrative, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.

- \*\*\*\*\* , “Specialist”, në Sektorin e Financës, Drejtoria e Financës. (Vendim nr. 711, datë 6.3.2018 i Përgjegjës të Sektorit të Financës).

Në mënyrë më të detajuar konstatohet se:

Për nëpunësen \*\*\*\*\* , ecuria disiplinore ka filluar me shkresën nr. 608 prot., datë 23.2.2018 të Sektorit të Burimeve Njerëzore, drejtuar Përgjegjës të Sektorit të Financës, që është sektori në të cilin nëpunësja kryen detyrën si specialist. Më pas, Përgjegjësi i Sektorit të Financës me shkresën nr. 608/1 prot., dt. 26.2.2018, “Njoftim për fillimin e procedimit administrativ disiplinor”, ka njoftuar nëpunësen për fillimin e ecurisë disiplinore, për mosrespektim të orarit të punës, si dhe datën dhe orën në të cilën do të realizohej dëgjimi i saj, për të dhënë sqarime rreth faktit të pretenduar si shkelje disiplinore, (dt. 2.3.2018, ora 10:00). Në takimin e realizuar nëpunësja ka sqaruar se, për arsye shëndetësore ka bërë disa analiza mjekësore dhe për këtë arsye, nuk ka arritur të respektojë orarin në punë. Sqarimet për shkeljen e pretenduar, i ka paraqitur edhe me shkrim, (shkresa nr. 608/2, dt. 1.3.2018 “Pretendime lidhur me ecurinë disiplinore). Pas kryerjes së kësaj procedure, Përgjegjësi i Sektorit të Financës ka nxjerrë vendimin nr. 711, datë 6.3.2018, për marrje mase disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunëses në fjalë. Ndaj këtij akti, nëpunësja nuk ka paraqitur ankim.

Bazuar në faktet e përmendura më sipër, rezulton se, ndaj nëpunëses \*\*\*\*\* , është zbatuar masa disiplinore “Vërejtje”, e parashikuar nga shkronja “a”, e nenit 58 të ligjit nr. 152/2013,

“Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Më tej, pika 1, e nenit 59 të ligjit përcakton se: “Masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a”, të nenit 58 të këtij ligji, merret nga eprori direkt. Eprori direkt detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen me faj të detyrimeve nga nëpunësit civil”.

Përkufizimi i termit “eprori direkt”, jepet në shkronjën “e”, të nenit 4, të ligjit për nëpunësin civil, ku në mënyrë të shprehur përcaktohet se:

“Epror direkt” është:

- i) Titullari i institucionit për nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese, përfshirë nëpunësit në pozicionet e koordinatorit të posaçëm dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë;
- ii) Sekretari i përgjithshëm apo nëpunësi në pozicion ekuivalent me të, për drejtorët e drejtorive dhe drejtuesit e degëve territoriale të institucionit;
- iii) Titullari i institucionit të varësisë për drejtorët brenda këtij institucioni;
- iv) Drejtori i drejtorisë për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të tjera”.

Në rastin konkret, të gjitha veprimet për marrjen e masës disiplinore janë kryer nga “Përgjegjësi i Sektorit të Financës” dhe jo nga “Drejtori i Drejtorisë së Financës”, i cili në këtë rast paraqitet si eprori direkt i nëpunësit ndaj të cilit ka filluar ecuria disiplinore. Nga verifikimet e kryera rezulton se, në momentin e realizimit të kësaj ecurie disiplinore, pozicioni “Drejtor i Drejtorisë së Financës”, ishte vend i lirë, (ky pozicion pune deri në datën 15.2.2018, është mbajtur nga \*\*\*\*\*, e cila me aktin nr. 495 prot., dt. 15.2.2018 të njësisë përgjegjëse, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, është transferuar në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Ekzekutimit të pagesave”). Në këto rrethana në cilësinë e eprorit direct, duhet të vepronte titullari i institucionit.

Për sa u parashtrua më sipër, vlerësojmë se vendimi nr. 711, datë 6.3.2018 i Përgjegjësit të Sektorit të Financës, në Drejtorinë e Financës, në AZHBR, për marrje mase disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*, në vështrim të nenit 108, të Kodit të Procedurave Administrative, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.

➤ **2 procedura** disiplinore, janë realizuar për “shkelje shumë të rënda”.

Shkeljet disiplinore shumë të rënda janë përcaktuar në pikën 2, të nenit 57 të ligjit dhe në këtë rast, masa disiplinore që zbatohet ndaj nëpunësit civil është, “largim nga shërbimi civil”, e parashikuar në shkronjën “ç”, të nenit 58 të ligjit.

Në institucionin e mbikëqyrur u konstatua se, masa disiplinore “largimi nga shërbimi civil”, e parashikuar si ndëshkimi administrativ, më i rëndë për një nëpunës civil, është zbatuar në 2 raste.

Në mënyrë më të detajuar u konstatua se:

Për \*\*\*\*\*, me detyrë ish “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit, me vendimin nr. 2557, datë 6.10.2017 të komisionit të disiplinës, është marrë masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”. Komisioni i disiplinës është ngritur me aktin nr. 201 prot., datë 21.9.2017 “*Për ngritjen e komisionit disiplinor ndaj \*\*\*\*\*, inspektor pranë AZHBR-së*”, të titullarit të institucionit. Me autorizimin nr. 5694/1, dt. 25.9.2017, të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, anëtari i komisionit Andri Gjini, në cilësinë e përfaqësuesit të DAP-it, është zëvendësuar me \*\*\*\*\*.

Vendimi nr. 2557/15, datë 6.10.2017, i komisionit të disiplinës, për marrje mase disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila në përfundim të shqyrtimit me vendimin nr. 643(80-2018-651), datë 26.2.2018, ka vendosur:

- “*Pranimin e padisë.*”
- *Shfuqizimin e aktit administrativ në trajtën e vendimit nr. 2557, datë 6.10.2017 të komisionit disiplinor, pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural dhe detyrimin e palës së paditur të kthejë paditësin \*\*\*\*\* në vendin e mëparshëm të punës, duke i paguar pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës deri në kthimin në vendin e punës. ...”.*

Kundër këtij vendimi, institucioni ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, (*kërkesë ankimore nr. 1012 prot., dt. 30.3.2018; regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 455 prot., dt. 12.3.2018*). Çështja është në shqyrtim pranë kësaj gjykate.

Për \*\*\*\*\*, me detyrë ish “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit, me vendimin nr. 2557, datë 6.10.2017 të komisionit të disiplinës, është marrë masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”. Komisioni i disiplinës është ngritur me aktin nr. 201 prot., datë 21.3.2017 “*Për ngritjen e komisionit disiplinor ndaj \*\*\*\*\*, inspektor pranë AZHBR-së*”, të titullarit të institucionit. Me autorizimin nr. 5695/1, dt. 25.9.2017, të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, anëtari i komisionit Andri Gjini, në cilësinë e përfaqësuesit të DAP-it, është zëvendësuar me \*\*\*\*\*.

Vendimi nr. 2557/15, datë 6.10.2017, i komisionit të disiplinës, për marrje mase disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila në përfundim të shqyrtimit me vendimin nr. 240(80-2018-231), datë 31.1.2018, ka vendosur:

- “*Pranimin e padisë së paditësit \*\*\*\*\*.*”
- *Shfuqizimin e aktit administrative, vendimit nr. 2557, datë 6.10.2017 të komisionit disiplinor, pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.*

- *Detyrimin e palës së paditur, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, të rikthejë paditësin \*\*\*\*\* në vendin e mëparshëm të punës, duke i paguar pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në kthimin në detyrë. ... ”.*

Kundër këtij vendimi, institucioni ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, (*kërkesë ankimore nr. 647 prot., dt. 28.2.2018; regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 1335 prot., dt. 8.2.2018*). Çështja është në shqyrtim pranë kësaj gjykate.

Në rastin e nëpunësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, të cilët vendimin e komisionit të disiplinës për marrje mase disiplinore *“largim nga shërbimi civil”*, e kanë kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe më tej, vendimi i kësaj gjykate është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, vlerësojmë që, në përfundim të shqyrtimit të çështjeve përkatëse, të vijohet sipas urdhërimit të gjykatës.

### **Konstatim:**

Nga verifikimet e kryera rezulton se, vendimet për marrje mase disiplinore janë protokolluar me të njëjtin numër protokoll dhe në të njëjtën datë, (*janë regjistruar me nr. 2557, datë 6.10.2017*). Nisur nga ky fakt, sjellim në vëmendjen e njësisë së burimeve njerëzore se akti për marrje mase disiplinore, *“largim nga shërbimi civil”*, është akt administrativ individual, i parashikuar në shkronjën “ç”, të nenit 58 të ligjit.

Gjithashtu, mënyra se si janë protokolluar këto akte në rregjistër, nuk është në përputhje me *“Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”*, në të cilat është parashikuar se: *“Nuk lejohet evidencimi në një numër i dy ose më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre, sipas objektit”*.

### **VIII. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces nga momenti i fillimit të efekteve juridike të aktit nënligjor që e ka përfshirë institucionin në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar e në vijim.**

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u verifikua procedura e ndjekur nga institucioni për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë për 6 mujorin e dytë të vitit 2017, në përputhje me kërkesat e nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, ndryshuar me VKM nr. 252, dt. 30.3.2016.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, ndërsa për nëpunësit civilë në periudhë prove, periudha e vlerësimit është vjetore dhe llogaritet nga data e emërimit në detyrë të nëpunësit civil.



Për realizimin e një vlerësimi sa më objektiv, në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, është përcaktuar procedura që duhet të respektohet për realizimin e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë si dhe kompetencat për vlerësimin. Gjithashtu, pjesë e këtij vendimi, është edhe formulari i vlerësimit të punës, i miratuar për nëpunësit civilë. (Lidhja 2, “Formulari i vlerësimit të punës për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

Në formularin e vlerësimit janë materializuar të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (ndarja A); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (ndarja B); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (ndarja C); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, kërkesën për këshillim, aftësinë menaxheriale për nëpunësit në pozicionet e nivelit të ulët e të mesëm drejtues (ndarja Ç); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmbledhur i arritjes së objektivave kryesore të punës nga nëpunësit; nënshkrimi (ndarja D), e cila plotësohet nga zyrtari raportues/kundërfirmues/autorizues dhe nëpunësi pas takimit për diskutimin e vlerësimit përfundimtar të nëpunësit.

Në zbatim të programit të kontrollit, për të gjithë nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes punonin në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, u verifikuan vlerësimet e rezultateve në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2017, ku u konstatua se:

Për vlerësimin e rezultateve në punë është përdorur formulari i vlerësimit që jepet në lidhjen nr. 2, bashkëlidhur VKM nr. 109, dt. 26.2.2014, i ndryshuar.

Nga verifikimi i Formularëve të vlerësimit të vëna në dispozicion nga Sektori i Burimeve Njerëzore, për 6 mujorin e dytë të vitit 2017, periudha korrik – dhjetor 2017, u konstatua se:

- për **38** nëpunës procesi i vlerësimit ka përfunduar;
- për **16** nëpunës procesi i vlerësimit nuk ka përfunduar, pasi nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat e ndarjes “D”, të titulluar “Nënshkrimi”;
- për **12** nëpunës procesi i vlerësimit nuk është kryer;
- **3** nëpunës kanë qenë me leje lindje dhe nuk iu është bërë vlerësim i pjesshëm. (Në këtë rast, bëhet fjalë për nëpunësit \*\*\*\*\*, e cila ka filluar lejen e lindjes në dt. 1.12.2017; \*\*\*\*\*, e cila ka filluar lejen e lindjes në dt. 13.11.2017 dhe \*\*\*\*\*, e cila ka filluar lejen e lindjes në dt. 4.9.2017. Për punonjëset në fjalë, për periudhën korrik-dhjetor 2018, duhet të ishte bërë vlerësim i pjesshëm i rezultateve në punë.

(Nivelin e vlerësimit “shumë mirë” (1)/ “mirë” (2)/ “kënaqshëm” (3)/ “jokënaqshëm” (4) për secilin nëpunës që ka përfunduar vlerësimin, si dhe komentet përkatëse për nëpunësit që nuk ka

*përfunduar apo nuk është kryer vlerësimi, i kemi paraqitur në kolonën 10, të titulluar “Shënime/ Vlerësimet për periudhën korrik-dhjetor 2017”, të tabelës nr. 2: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës, për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil”, që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij).*

Për periudhën e vlerësimit objekt verifikimi, në institucionin e mbikëqyrur, u vërejt se në disa raste, ka pasur vlerësime të pjesshme, për faktin se ka ndryshuar zyrtari raportues.

Në këto raste, vlerësojmë se nga zyrtari përgjegjës që mbart detyrim për vlerësimin e nëpunësve, është kuptuar dhe zbatuar drejt detyrimi ligjor sipas pikës 6, të kreut III, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

*“Në rast se gjatë periudhës së vlerësimit, zyrtarët që duhet të bëjnë vlerësimin largohen nga ai pozicion apo ndodhen në pamundësi të vazhdimit të mëtejshëm të detyrës, ata janë të detyruar të bëjnë vlerësimin për nëpunësin/nëpunësit për periudhën gjatë të cilës kanë ushtruar detyrën.”*

Në një rast, bëhet fjalë për nëpunësen \*\*\*\*\*\*, u konstatua se kjo nëpunëse është vlerësuar në nivelin 4 “jokënaqshëm”. Në ndarjen “D: Nënshkrimi”, nëpunësja ka deklaruar se nuk është dakord me vlerësimin. Në ndarjen “DH: Rivlerësimi nga zyrtari autorizues”, zyrtari autorizues, ka përshkruar disa detyra dhe përgjegjësi të cilat sipas tij, nëpunësja nuk i ka realizuar e që janë konsideruar mospërmbushje e pritshmërisë në lidhje me qëndrimin dhe sjelljen profesionale. (Në këtë rast si zyrtar autorizues paraqitet titullari i institucionit, i cili ka vepruar në të njëjtën kohë edhe si zyrtar raportues dhe si zyrtar kundërfirmues). Por, formulari i vlerësimit nuk i është dorëzuar nëpunëses së vlerësuar, me qëllim vënien në dijeni të saj dhe marrjen e konfirmimit nëse ajo është dakord me vlerësimin e rezultateve në punë, nuk është dakord apo më tej do t’a ankimojë në rrugë gjyqësore. Në këtë rast, vlerësojmë se procedura e vlerësimit nuk është përfunduar.

Bazuar në faktet e përmendura si më sipër, çmojmë se, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2017, nuk është kryer sipas përcaktimeve të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Gjithashtu edhe praktika e ndjekur në disa raste ku si “Zyrtar raportues” kanë vepruar nëpunës civil të nivelit ekzekutiv me detyrë specialist/inspektor, të cilëve ndjekja e detyrave të përgjegjësimit të sektorit iu është caktuar si detyrë shtesë e përkohshme me urdhër të titullarit të institucionit apo në bazë të listës së planit të zëvendësimit, nuk është në përputhje me parashikimet e shkronjës “b”, të pikës 2, të VKM nr. 109, dt. 26.2.2014, i ndryshuar, ku në mënyrë të shprehur përcaktohet se, “Zyrtar raportues”, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative nëpunësin që do të vlerësohet.

Sjellim në vëmendje se, vendimi nr. 109, datë 26.2.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, në pikat 1, 2 e 3, të kreut III, ka përcaktuar në mënyrë të hollësishme detyrat që ka në procesin e vlerësimit zyrtari raportues/zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues. Më tej pika 5, e kreut III përcakton se, mosrealizimi i detyrave të përcaktuara në pikën 1, 2 dhe 3 konsiderohet mospërmbushje detyre, nga zyrtarët përkatës. Referuar përcaktimeve të shkronjës *“a”*, pika 3, të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, mospërmbushja e detyrës përbën shkelje të rëndë disiplinore.

Sa më sipër, nëpunësit përgjegjës, që ligji i ngarkon me administrimin e shërbimit civil, në lidhje me institutin e vlerësimit të punës në respektim të procedurave të hollësishme të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar dhe lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, të përfundojnë vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë, për 6 mujorin e dytë të vitit 2017, si dhe të ndjekë procesin për të respektuar procedurat dhe afatet edhe për 6 mujorin e parë të vitit 2018. Në përfundim të procesit, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil, duhet të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, siç parashikohet në pikën 18, të kreut II, të aktit nënligjor si më sipër.

#### ***Konkluzion:***

Duke marrë parasysh rrethanat e parashtruara në këtë pikë të raportit, arrihet në konkluzionin që, nëpunësit të cilët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, duhet të kujdesen që procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësit civilë, të përmbyllet duke respektuar të gjitha procedurat e hollësishme të përcaktuara në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar. (Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, nëpunës të përfshirë në procesin e vlerësimit janë nëpunësit e emëruar në pozicionet përgjegjës sektori, drejtor drejtorie, titullar institucioni si dhe njësia e burimeve njerëzore).

Gjithashtu, formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, i cili plotësohet çdo 6 muaj brenda vitit kalendarik, apo në përfundim të periudhës së provës, është dokument që krijohet dhe miratohet nga nëpunësit e ngarkuar me kompetencën e vlerësimit dhe në këtë rast, duhet të plotësohen në mënyrën e duhur të gjitha ndarjet dhe elementet formalë të kërkuara nga formulari i vlerësimit.

Për këtë arsye, nëpunësit e ngarkuar me kompetencën e vlerësimit të rezultateve në punë, duhet të kujdesen që:

- ✓ Të plotësohen në mënyrë të plotë dhe të saktë, data e emërimit në pozicionin aktual/periudha e vlerësimit/ data e vlerësimit, si dhe të përzgjidhet saktë lloji i vlerësimit.
- ✓ Në ndarjen *“Vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë”*, të përzgjidhet vlerësimi i duhur dhe të vendoset shenja përkatëse.

- ✓ Zyrtari raportues/Zyrtari kundërfirmues/Zyrtari autorizues, në hapësirat përkatëse të paraqesin në mënyrë të qartë komentet dhe shpjegimet e tyre, të identifikojnë të plotë emrin dhe mbiemrin, pastaj të vendosin firmën dhe datën e nënshkrimit. Më tej, formulari i vlerësimit duhet t'i parqitet nëpunësit të vlerësuar, që të plotësojë në ndarjen përkatëse deklarinimin jam dakord/ nuk jam dakord dhe vendosjen e emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit të tij në ndarjen përkatëse.
- ✓ Në rastin e rivlerësimit të nëpunësit, vendimi përfundimtar për vlerësimin e rezultateve në punë duhet të jetë i arsyetuar në ndarjen përkatëse të formularit. Pas plotësimit të kësaj ndarje nga zyrtari autorizues, procesi duhet të vijojë me plotësimin e deklarinimit jam dakord/nuk jam dakord nga nëpunësi dhe vendosjen e nënshkrimit prej tij.
- ✓ Formularët e vlerësimit të plotësuar dhe të nënshkruar, të administrohen në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil.
- ✓ Nëpunësit e ngarkuar me detyrën e vlerësimit, duhet të bëjnë plotësime të natyrës teknike/materiale në formularët e vlerësimit të punës, me qëllim formalizimin e tyre, si çdo dokument tjetër zyrtar.

Për sa i takon mënyrës së vlerësimit, sfida e aktorëve të këtij procesi është përcaktimi i objektivave të qarta dhe të matshme, si dhe ndjekja e ecurisë së nëpunësve civilë nga ana e eprorit direkt, gjatë realizimit të objektivave dhe detyrave të tyre funksionale, me qëllim që vlerësimi i punës të vendoset në parametra sa më objektive.

#### **IX. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.**

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se, lirimi nga shërbimi civil, është zbatuar vetëm në rastet e paraqitjes së dorëheqjes nga detyra, rast ky i parashikuar në shkronjën “dh”, pika 1, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Vemë re se, për periudhën objekt mbikëqyrje, janë 20 nëpunës, të cilët kanë përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil, nëpërmjet dorëheqjes nga detyra.

Në mënyrë më të detajuar, rastet e lirimit nga shërbimi civil, si pasojë e dorëheqjes, janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Nr.	<b>Nëpunësi i larguar me dorëheqje</b> Emër/Mbiemër/Emërtesa e pozicionit të punës	<b>Akti i deklarinimit të statusit të punësimit</b> Akti i DAP, nr./dt.	Data e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil
1	*****	Akti i DAP nr. 1272/79, dt. 22.5.2017,	Dt. 31.10.2017,

	Specialist në Sektorin e Riskut, Parandalimit të Mashtrimit, Analizës, Raportimit	deklarohet “ <i>Nëpunës civil në periudhë prove</i> ”.	me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
2	***** Drejtor në Drejtorinë e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve	Akti i DAP nr. 1272/91, dt. 22.5.2017, deklarohet “ <i>Nëpunës civil</i> ”.	Dt. 25.9.2017, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
3	***** Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD	Akti i DAP nr. 1272/99, dt. 22.5.2017, deklarohet “ <i>Nëpunës civil</i> ”.	Dt. 15.1.2018, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
4	***** Përgjegjës i Sektorit të Autorizimit të Pagesave IPARD	Akti i DAP nr. 1272/26, dt. 22.5.2017, deklarohet “ <i>Nëpunës civil</i> ”.	Dt. 22.12.2017, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
5	***** Specialist në Sektorin e Ekzekutimit të Pagesave IPARD	Akti i DAP nr. 1272/92, dt. 22.5.2017, deklarohet “ <i>Nëpunës civil</i> ”.	Dt. 28.4.2017, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
6	***** Dretor në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse	Akti i DAP nr. 1272/56, dt. 22.5.2017, deklarohet “ <i>Nëpunës civil</i> ”.	Dt. 25.9.2017, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
7	***** Specialist në Sektorin Juridik	Akti i DAP nr. 1272/94, dt. 22.5.2017, deklarohet “ <i>Nëpunës civil në periudhë prove</i> ”.	Dt. 2.11.2017, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
8	***** Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore	Akti i DAP nr. 1272/61, dt. 22.5.2017, deklarohet “ <i>Nëpunës civil në periudhë prove</i> ”.	Dt. 22.1.2018, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
9	***** Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore	Akti i DAP nr. 1272/5, dt. 22.5.2017, deklarohet “ <i>Nëpunës civil</i> ”.	Dt. 2.6.2017, me kërkesë të nëpunësit për

			dorëheqje nga detyra.
10	***** Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore	Akti i DAP nr. 1272/17, dt. 22.5.2017, deklarohet “Nëpunës civil”.	Dt. 22.12.2017, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
11	***** Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit	Akti i DAP nr. 1272/39, dt. 22.5.2017, deklarohet “Nëpunës civil në periudhë prove”.	Dt. 9.2.2018, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
12	***** Specialist në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit	Akti i DAP nr. 1272/20, dt. 22.5.2017, deklarohet “Nëpunës civil”.	Dt. 29.9.2017, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
13	***** Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit	Akti i DAP nr. 1272/22, dt. 22.5.2017, deklarohet “Nëpunës civil”.	Dt. 24.8.2017, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
14	***** Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD	Akti i DAP nr. 1272/108, dt. 22.5.2017, deklarohet “Nëpunës civil”.	Dt. 19.1.2018, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
15	***** Inspektor në Sektorin e Kontrollit IPARD	Akti i DAP nr. 1272/93, dt. 22.5.2017, deklarohet “Nëpunës civil”.	Dt. 24.8.2017, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
16	***** Inspektor në Sektorin e Monitorimit të Skemave	Akti i DAP nr. 1272/115, dt. 22.5.2017, deklarohet “Nëpunës civil”.	Dt. 6.2.2018, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
17	***** Përgjegjës i Sektorit të Financës	Akti i DAP nr. 1272/24, dt. 22.5.2017, deklarohet “Nëpunës civil në periudhë prove”.	Dt. 30.4.2018, me kërkesë të nëpunësit për

			dorëheqje nga detyra.
18	***** Specialist në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit	Akti i DAP nr. 1272/121, dt. 13.6.2017, deklarohet “Nëpunës civil në periudhë prove”	Dt. 26.3.2018, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
19	***** Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD	Akt emërimi i DAP nr. 2112, dt. 28.3.2018, emërohet nëpunës civil në periudhë prove.	Dt. 10.4.2018, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
20	***** Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse	Akt emërimi i DAP nr. 6985, dt. 12.12.2017	Dt. 5.3.2018, me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.

Në këto raste, nëpunësit kanë njoftuar për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, nëpërmjet dorëheqjes. Më pas, lirimi nga shërbimi civil, është bërë me vendim të njësisë së burimeve njerëzore. Për të gjitha vendimet e liritimit nga shërbimi civil, njësia e burimeve njerëzore, ka vënë në dijeni njësinë përgjegjëse DAP.

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 64 parashikon institutin e dorëheqjes. Ky nen, pas ndryshimeve përkatëse, në pikën 4, në mënyrë të shprehur parashikon:

*“Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil”.*

Në mbështetje të përcaktimeve të kësaj dispozite, nëpunësit e liruar nga shërbimi civil me dorëheqje nga detyra, brenda periudhës 2-vjeçare, nga data e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, kanë të drejtë të konkurrojnë për procedurën e lëvizjes paralele, apo të ngritjes në detyrë, nëse plotësojnë kushtet minimale të përcaktuara në pikën 2, kreu VII, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhn e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”; pikën 2, kreu II dhe pikën 2, kreu III të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

### ***Konkluzion:***

- Vlerësojmë se, marrëdhënia në shërbimin civil ka përfunduar nëpërmjet lirimit nga shërbimi civil, për shkak të dorëheqjes nga detyra, parashikuar nga neni 64, si dhe shkronja “dh”, e pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

### ***Të tjera:***

Për periudhën objekt mbikëqyrje (nga momenti i fillimit të efekteve juridike të vendimit nr. 877, datë 14.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, që e ka përfshirë institucionin në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e deri në momentin e mbikëqyrjes), në subjektin e kontrolluar nuk u konstatuan:

- raste të pezullimit nga shërbimi civil të parashikuar në kreun IX “Pezullimi nga shërbimi civil”, (nenet 53-56).

### ***Mënyra e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes***

Bazuar në strukturën dhe organikën në fuqi, në momentin e mbikëqyrjes Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), ka **129** pozicione të shërbimit civil.

Mënyra e plotësimit të tyre në momentin e mbikëqyrjes paraqitet si më poshtë:

- **90 pozicione të shërbimit civil**, janë të plotësuar nga punonjës ekzistues.
- **19 pozicione të shërbimit civil**, janë të plotësuar nga nëpunës të emëruar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- **20 pozicione të shërbimit civil**, janë vende të lira. Në këtë rast, bëhet fjalë për pozicionet e punës:
  - Përgjegjës i Sektorit të Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD;
  - 1 pozicion për Inspektor, në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD;
  - Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit;
  - Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Skemave;
  - Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit IPARD;
  - Përgjegjës i Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare;
  - 1 pozicion për Inspektor në Sektorin e Kontrollit të Skemave Kombëtare;
  - Drejtor i Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave;
  - Përgjegjës i Sektorit të Autorizimit të Pagesave IPARD;



- Përgjegjës i Sektorit të Ekzekutimit të Pagesave IPARD;
- Përgjegjës i Sektorit të Ekzekutimit të Pagesave Kombëtare;
- 1 pozicion për Inspektor në Sektorin e Ekzekutimit të Pagesave Kombëtare;
- Drejtor i Drejtorisë së Financave;
- 1 pozicion për Specialist në Sektorin e Kontabilitetit;
- Përgjegjës i Sektorit të Financës;
- Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore;
- Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit;
- 1 pozicion për Specialist në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit;
- Përgjegjës i Sektorit të Promocionit dhe Komunikimit.

## **X. Dosjet e personelit**

### **a. Dosja e personelit**

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u këqyrën dosjet e personelit, për të verifikuar nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe kërkesave të vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Nisur nga përmbajtja e dispozitave ligjore si më lart, në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, duhet të jenë të përfshira dokumentet me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, në dosjet personale të nëpunësve, duhet të administrohen: dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnjoftimit*); dokumenti mbi gjendjen civile (*çertifikata e gjendjes familjare*); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*); për diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të administrohet vërtetimi i njohjes dhe njësimi të diplomës i lëshuar nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi; dokumentet që vërtetojnë fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*); aktet që provojnë procesin e deklaramit të statusit të punësimit; aktet që vërtetojnë gjendjen gjyqësore, vërtetimi i gjendjes shëndetësore (*raporti mjekësor*). Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjet e personelit, u konstatua se, këto dokumente janë të përfshira në dosjen e çdo nëpunësi. Plotësimi i këtyre kërkesave për secilin nëpunës, është pasqyruar në tabelat që i bashkëlidhen raportit, si pjesë e tij.

Sjellim në vëmendje të institucionit se, vërtetimi i gjendjes shëndetësore, duhet të paraqitet pranë burimeve njerëzore të institucionit, brenda datës 10 janar të çdo viti, parashikuar në pikën 23, të

kreut III, të vendimit nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*.

Të gjitha dokumentet, duhet të pasqyrohen në fletë inventarin dhe në fletën prezantuese, të cilat përfshihen në dosjen teknike të nëpunësit, por, në të gjitha rastet, fleta prezantuese mungonte ndërsa fleta e inventarit nuk i përgjigjej kërkesave të ligjit, sikurse përcaktohet në lidhjen 1 dhe 2, të vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*.

Në një rast u konstatua se, nëpunësja \*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, lidhur me kërkesat e posaçme të vendit të punës, nuk ka dorëzuar çertifikatën si *“Auditues i brendshëm”*, megjithëse tashmë kanë përfunduar afatet e vendosura nga pika 2/ç, të nenit 11, të ligjit nr. 114/2015, *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, ku parashikohet se *“Punonjësi, që nuk zotëron çertifikatën si “Auditues i brendshëm”, por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t’i nënshtrohet detyrimit të procedurës së çertifikimit si “Auditues i brendshëm”. Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk çertifikohet si “Auditues i brendshëm”, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të ligjit”*.

Përsa i përket kushteve të ruajtjes, dosjet e personelit ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore.

### ***Konkluzion:***

Në lidhje me mangësitë e konstatuara, si dhe për të siguruar një administrim efikas të shërbimit civil, njësia e ngarkuar me detyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionin e mbikëqyrur, duhet të mbajë parasysh që:

- Të plotësojë të gjitha dosjet e personelit me fletën prezantuese të dosjes teknike dhe fletën e inventarit të dosjes së nëpunësit sipas lidhjeve 1 dhe 2, bashkëlidhur vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”* dhe të plotësohen ato me të gjitha të dhënat e kërkuara.
- Në fletën prezantuese të dosjes teknike të nëpunësit, në pikën që kërkohet *“Përshkrimi i karrierës”*, për të gjitha emërimet që nëpunësi ka patur në institucion të plotësohen në mënyrë kronologjike data e fillimit të marrëdhënieve juridike të punës dhe atyre financiare dhe emërtesa e pozicionit të punës, duke filluar nga momenti fillestar i emërimit e në vijim.

- Të administrohen në dosjen individuale të nëpunësit, të gjitha aktet e emërimit, që pasqyrojnë në mënyrë kronologjike lëvizjet e nëpunësit nga momenti i fillimit të marrëdhënieve juridike të punës dhe atyre financiare e në vijim, (*aktet që pasqyrojnë ndryshim të pozicionit të punës, strukturim të pozicionit të punës, ndryshim të kategorisë së pozicionit të punës etj, ndryshime që lidhen me pozicionin e punës*).
- Përshkrimet e punës dhe vlerësimet e punës, të plotësuara dhe të nënshkruara nga nëpunësit përgjegjës, (*të formalizuara si çdo dokument tjetër zyrtar që krijohet nga institucioni*), të administrohen në dosjen individuale të nëpunësit civil.

Nga të dhënat e dokumenteve të administruara në dosjet e personelit, konstatohet se:

Në institucionin **Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR)**, në momentin e mbikëqyrjes janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil **109** punonjës, ku 44 punonjës ose 40 % e tyre janë femra, 65 punonjës ose 31 % e tyre janë meshkuj dhe 20 pozicione pune (*ose 16 % e pozicioneve të shërbimit civil*), janë vende të lira. Ndërsa, mosha mesatare e nëpunësve është **44** vjeç.

Përsa i përket arsimit, konstatohet se:

- **97 nëpunës**, kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore publike;
- **9 nëpunës**, kanë kryer arsimin e lartë në institucione private;
- **3 nëpunës**, kanë mbaruar arsimin e lartë në institucione arsimore jashtë Republikës së Shqipërisë.

#### ➤ **Regjistri i personelit**

Regjistri Qendror i Personelit si një bazë unike të dhënash elektronike, në të cilën ruhet, përpunohet dhe menaxhohet informacioni për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, në kuptim të ligjit administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

Institucioi i mbikëqyrur ka akses në sistem dhe e ushtron këtë funksion nëpërmjet nëpunësit të autorizuar. Në sistem bëhet plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të parashikuara në lidhjen 3 “*Përkufizimi i administruesve dhe përdoruesve të sistemit*”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 117, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit të personelit*”.

### **XI. Kërkesa/Informacione të paraqitura nga nëpunës të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave).**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil kanë ardhur për shqyrtim disa kërkesa/informacione të paraqitura nga nëpunës të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (*Agjencia e Pagesave*). Për trajtimin sa më të plotë dhe objektiv të tyre, këto informacione/ kërkesa janë trajtuar bashkë me mbikëqyrjen e kryer në institucionin e AZHBR-së.

Më konkretisht, bashkë me mbikëqyrjen e kryer në institucionin e AZHBR-së, janë trajtuar edhe kërkesat/informacionet si më poshtë:

1. Kërkesa/ informacioni protokolluar me nr. 323 prot., datë 9.3.2018, e paraqitur nga nëpunësi \*\*\*\*\*\*, ish Drejtor në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, në AZHBR, i cili pretendon për parregullsi në administrimin e shërbimit civil, gjatë nxjerrjes së vendimit nr. 625 prot., datë 28.2.2018, të Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, për lirim nga shërbimi civil, për shkak të ndryshimit të kriterëve të vendit të punës, në kuadër të ristrukturimit të institucionit.
2. Kërkesa e datës 10.3.2018, protokolluar me nr. 340 prot., datë 15.3.2018, e paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\*\*, ish Drejtore në Drejtorinë e Ekzekutimit të Pagesave, në AZHBR, e cila pretendon për parregullsi në administrimin e shërbimit civil gjatë nxjerrjes së vendimit nr. 277 prot., datë 30.1.2018, të Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, për lirim nga shërbimi civil, për shkak të ndryshimit të kriterëve të vendit të punës, në kuadër të ristrukturimit të institucionit.
3. Kërkesa e datës 22.1.2018, protokolluar me nr. 179 prot., date 23.1.2018, e paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, në AZHBR, e cila pretendon për parregullsi në administrimin e shërbimit civil, në xjerrjen e aktit nr. 141, dt. 15.1.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të AZHBR-së *“Vendim në përfundim të periudhës së provës”*, me të cilin është vendosur moskonfirmimi si nëpunës civil për shkak se kjo punonjëse nuk rezulton në listën e nëpunësve të çertifikuar si Auditues të Brendshëm.
4. Verifikimi i ligjshmërisë së procedurës së kryer për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), i filluar kryesisht nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me urdhrin nr. 364 prot., datë 26.3.2018 *“Për verifikimin e rastit të publikuar nga media, në lidhje me emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor Rural (AZHBR)”*.

Kërkesat/informacionet e paraqitura nga nëpunësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*\*, janë trajtuar në projektraport, në pikën V *“Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste, (ristrukturimi, ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin si dhe rastet e tjera të transferimit”*, nënpika *“Raste të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit”*.

Verifikimi i ligjshmërisë së procedurës së kryer për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), i filluar kryesisht nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me urdhrin nr. 364 prot., datë 26.3.2018 është trajtuar në projektraport, në pikën I.b *“Vlerësimi i pozicionit Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si titullar i një institucioni në varësi të ministrit përgjegjës për bujqësinë, në raport me shërbimin civil”*.

**X.1 Kërkesa e datës 22.1.2018, protokolluar me nr. 179 prot., date 23.1.2018, e paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\*\*, Specialiste në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, në AZHBR.**

Me administrimin e kartelës shoqëruese dhe praktikës me nr. 179 prot., datë 23.1.2018 *“Ankesë në lidhje me vendimin e përfundimit të periudhës së provës”*, u krye hetimi paraprak i rastit, nga ku rezultoi se:

Me aktin nr. 83, datë 15.3.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm *“Për emërim në detyrë”*, punonjësja \*\*\*\*\*\*, është emëruar në pozicionin *“Specialiste në Sektorin e Auditimit”*, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR).

Marrëdhënia e punës, ka vazhduar me të njëjtin regjim juridik, deri në momentin e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, të Këshillit të Ministrave *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”*, i cili e përfshin institucionin në skemën e administrimit të shërbimit civil. Në këtë vendim, ndër të tjera, përcaktohet që:

- *“Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil”*. (Pika 9)
- *“Për nëpunësit aktualë të AZHBR-së, zbatohen dispozitat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar”*. (Pika 17)

Me fillimin e efekteve të vendimit të mësipërm, Departamenti i Administratës Publike, i cili paraqitet si njësi përgjegjëse për institucionin e AZHBR-së, në kuadrin e plotësimit të detyrës ligjore të deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit e gjendur në pozicione të shërbimit civil, me aktin nr. 1272/83, datë 22.5.2017, ka deklaruar statusin e punësimit *“Nëpunës civil në periudhë prove”*, në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm”*, për punonjësën \*\*\*\*\*.

Duke vazhduar në këtë linjë, pas përfundimit të periudhës së provës (dhjetor 2017), njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, ka nxjerrë aktin nr. 141 prot., datë 15.1.2018, *“Vendim në përfundim të periudhës së provës”*, me anë të të cilit bëhet njoftimi i nëpunëses për moskonfirmimin si nëpunës civil, në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm”*, për mosplotësim të kushteve të posaçme të vendit të punës.

Duke analizuar me hollësi gjithë aktet e vëna në dispozicion për hetimin e rastit (*akti i emërimit, diploma e studimeve universitare, kopje e librezës së punës*), rezulton se punonjësja \*\*\*\*\*, që në momentin e fillimit të marrëdhënies së punës, nuk plotësonte disa nga kriteret e nevojshme, për emërimin e saj në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm*”.

Së pari, në momentin që ka filluar punë, punonjësja nuk kishte përfunduar studimet universitare dhe nuk ishte pajisur me diplomën përkatëse të arsimit të lartë. Konkretisht, diploma e nivelit të dytë në fushën e të drejtës civile, për punonjësën në fjalë, është lëshuar në datën 30 gusht 2016, që do të thotë se, në momentin e emërimit të punonjësës me aktin nr. 83, datë 15.3.2016 “*Për emërim në detyrë*”, ajo ende nuk plotësonte kriterin arsimor të kërkuar nga neni 11, pika 2/a, e ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, ku thuhet shprehimisht që: “*Për punonjësit që punësohen në njësinë e auditimit të brendshëm, kërkohet ... të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet*”.

Në vijim të këtij arsytimi, punonjësja në fjalë, nuk plotësonte as kriterin e kërkuar në pikën 2/ç, të nenit 11 të ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, ku parashikohet se, punonjësi që nuk zotëron çertifikatën si “*Auditues i brendshëm*”, por ka përvojë pune 3 vjet në profesion (*vjetërsi të cilën nuk e kishte*), punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm, me kusht që gjatë 2 viteve të para të punojë nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë dhe brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t’i nënshtrohet detyrimisht procedurës së çertifikimit si “*Auditues i brendshëm*”. Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk plotëson këtë kriter, i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji.

Mangësitë e lejuara në momentin e lidhjes së marrëdhënies së punës të punonjësës në fjalë, qëndrojnë në mosrespektimin e kërkesave ligjore të përcaktuara nga:

- ✓ ligji i posaçëm material (*ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*);
- ✓ Rregullorja “*Për procedurat e çertifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik*”;
- ✓ vendimi nr. 116, datë 17.2.2016 “*Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit*”.

Këto parregullsi të çojnë në përfundimin se akti administrativ, që ka shërbyer për lidhjen e marrëdhënies së saj të punës, është nxjerrë në kundërshtim me ligjin (*akt i paligjshëm, i nxjerrë në kundërshtim me ligjin material, gjë e cila parashikohet prej pikës “d” të nenit 109, të ligjit*

nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si rast i një akti administrativ të paligjshëm).

Në ankesën dërguar pranë Komisionerit, nga ana e punonjësës është ngritur pretendimi se nuk është përmbushur afati 2-vjeçar i parashikuar në ligj për certifikimin si auditues i brendshëm (neni 11, shkronja “ç”).

Lidhur me këtë fakt, sqarojmë se, aplikimi në procesin e çertifikimit si auditues i brendshëm është individual; kushtet dhe kriteret e aplikimit përcaktohen në ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Rregulloren “Për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik”; si dhe në vendimin nr. 116, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e komisionit të kualifikimit të auditueve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”.

Nga gjithë dokumentacioni i administruar gjatë procesit të hetimit të rastit, nuk është evidentuar asnjë dokument apo material tjetër shkresor, i cili të tregojë interesimin nga ana e punonjësës \*\*\*\*\* , për të aplikuar në procesin e çertifikimit.

Ndërkohë, gjatë kryerjes së hetimit administrativ, u administrua shkresa nr. 378 prot., datë 9.1.2018 “Njoftim për pjesëmarrje në trajnimin profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik për vitin 2018”, me anë të së cilës Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm ka njoftuar, ndër të tjerë, edhe institucionin e AZHBR-së, për fillimin e sezonit të trajnimit profesional të audituesve të brendshëm në detyrë, për vitin 2018, me qëllim konfirmimin e aplikantëve që do të marrin pjesë në këtë trajnim.

Nga dokumentacioni i administruar, konstatohet se punonjësja \*\*\*\*\* , nuk figuron të ketë aplikuar për të marrë pjesë dhe për t’u çertifikuar si “Auditues i brendshëm”, në trajnimin e planifikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2018. Referuar këtij argumenti, si dhe në kushtet kur afati 2 vjeçar i parashikuar në ligj për certifikimin si auditues i brendshëm për punonjësën në fjalë ka qenë drejt përfundimit, (pasi aktualisht ky afat ka përfunduar në datën 15.3.2018), njësia e burimeve njerëzore e institucionit, duke vlerësuar se ka shteruar mundësia për plotësimin e këtij kriteri nga ana e punonjësës në fjalë, ka vendosur moskonfirmimin si nëpunës civil të saj, për shkak se nuk plotëson kushtin e çertifikimit si auditues i brendshëm.

Përveç kriterëve të përmendura më sipër, në këtë relacion, në pikën 2, të nenit 20, kreu IV “Kriteret e kualifikimit të audituesve të brendshëm”, theksohet se, audituesit i nënshtrohen trajnimit të vijueshëm profesional, të paktën 80 orë në 2 vjet, kushte të cilat ankuesja, gjithashtu, nuk i ka respektuar.

Ndërkaq, pavarësisht fakteve të përshkruara më sipër, konstatohet që në momentin e ndryshimit të statusit juridik të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, duke e përfshirë atë përsëri në

fushën e shërbimit civil (*shih, vendimin nr. 877, dt. 14.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, dt. 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”*), Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse për institucionin, duke u bazuar në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, ka deklaruar statusin e punësimit për punonjësit që ishin të punësuar në pozicion të shërbimit civil. Në këtë kuadër, ndër të tjera, me aktin nr. 1272/83, datë 22.5.2017 ka deklaruar edhe statusin e punësimit si *“Nëpunës civil në periudhë prove”*, në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm”* për punonjësen \*\*\*\*\*.

Në përfundim të analizës së këtij rasti, rezulton që, marrëdhënia e punësimit për punonjësen \*\*\*\*\*; e filluar nëpërmjet aktit të emërimit nr. 83, datë 15.3.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm *“Për emërim në detyrë”*, në pozicionin *“Specialiste në Sektorin e Auditimit”*, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), është një veprim juridik i kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit material (ligji nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*; Rregullorja *“Për procedurat e çertifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik”*; si dhe, VKM nr. 116, datë 17.2.2016 *“Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e komisionit të kualifikimit të auditueve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”*).

Referuar fakteve të përmendura më sipër, ku punonjësja në momentin e emërimit në detyrë nuk e kishte përfunduar arsimin e lartë në nivelin *“Master Shkencor”*, në fushën e kërkuar nga ligji; si dhe, duke marrë parasysh faktin që kjo punonjëse, deri në kohën e kryerjes së këtij hetimi administrativ, nuk ka bërë asnjë përpjekje për plotësimin e kërkesave të posaçme të ligjit, për pozicionin e punës që mban dhe për pasojë, në përfundim të afatit 2 vjeçar, nuk është pajisur me çertifikatën e auditit, arrihet në konkluzionin se:

Veprimi administrativ i eprorit, për mos konfirmimin në fund të periudhës së provës, i punonjësës \*\*\*\*\*; në pozicionin *“Specialiste në Sektorin e Auditimit të Brendshëm”*, pranë AZHBR-së, i kryer me aktin nr. 141 prot., datë 15.1.2018, *“Vendim në përfundim të periudhës së provës”*, me anë të të cilit bëhet njoftimi i nëpunëses për moskonfirmimin e statusit të punësimit, është një veprim i mbështetur në ligj dhe si rrjedhojë ajo nuk mund të vazhdojë të punojë në atë pozicion pune. Nga ana e institucionit duhet të përmbillet procedura duke ndërprerë marrëdhënien e punës për punonjësen \*\*\*\*\*.

\*

\* \*

Këto ishin rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, njësia e burimeve njerëzore e institucionit dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, duke filluar nga



hyrja në fuqi e vendimit nr. 877, datë 14.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, që e ka përfshirë institucionin në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, (nga dt. 22.12.2016), e në vijim.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat:

*Tabela nr. 1: “Nëpunës të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes”.*

*Tabela nr. 2: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës, për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil”.*

Këto tabela i bashkëlidhen raportit, si pjesë e tij.

Njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të marrin masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri, në vendimin e paralajmërimit, brenda afatit të vendosur në vendim, për të rregulluar situatën e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**